FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare
www.legjislacionishqiptar.gov.al
www.qpz.gov.al

Nr.158 18 tetor 2008

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i KM nr.1321, datë 1.10.2008	Për transferimin në pronësi të bashkisë Gramsh, të pronës së paluajtshme, shtetërore, ndërtesa 2 kate, zyra, garazh dhe vendrojë, të Shërbimit Informativ të Shtetit, në këtë qytet, dhe për një ndryshim në vendimin nr.359, datë 5.6.2003 "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme, shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Shërbimit Informativ Shtetëror", e për një shtesë në vendimin nr.431, datë 11.7.2007 "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që i transferohen, në pronësi ose në përdorim, bashkisë Gramsh, të qarkut të Elbasanit" të Këshillit të Ministrave ……	7731
Vendim i KM nr.1322, datë 1.10.2008	Për kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Autoriteti Portual, Durrës, Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës të kinoklubit "Mujo Ulqinaku", dhe për një ndryshim në vendimin nr.586, datë 10.9.2004 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e listave të inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat u kalojnë në përgjegjësi administrimi shoqërive anonime dhe ndërmarrjeve të sistemit të transportit detar dhe ajror" ……	7733
Vendim i KM nr.1323, datë 1.10.2008	Për kalimin në pronësi, nga ARMO sh.a.-ja, Tiranë, bashkisë Kuçovë, të ish-uzinës së përpunimit të naftës, Kuçovë, dhe për një ndryshim në vendimin nr.208, datë 16.4.2004 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme, shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi ARMO sh.a.-së" ……	7739

Vendim i KM nr.1324, datë 1.10.2008	Për kalimin në përgjegjësi administrimi nga Ministria e Shëndetësisë, Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror të ndërtesës së ish-spitalit, Poliçan, dhe për një shtesë në vendimin nr.60, datë 1.2.2006 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Shërbimit Social Shtetëror" ……	7741
Vendim i KM nr.1325, datë 1.10.2008	Për një ndryshim në vendimin nr.277, datë 18.6.1997 të Këshillit të Ministrave "Për përfitimet nga statusi i të verbërit", të ndryshuar ……	7745
Vendim i KM nr.1330, datë 1.10.2008	Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të bashkisë Peqin, të qarkut të Elbasanit ……..	7745
Vendim i KM nr.1331, datë 1.10.2008	Për hapjen e programeve të studimit, të ciklit të dytë, pranë Universitetit të Tiranës, në vitin akademik 2008-2009 ……	7746
Vendim i KM nr.1332, datë 1.10.2008	Për hapjen e programit të studimit, master i nivelit të parë në mësuesi, për ciklin e lartë të arsimit bazë, pranë universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, në vitin akademik 2008-2009 ……	7747
Vendim i KM nr.1333, datë 1.10.2008	Për hapjen e programeve të studimit, master i nivelit të parë në mësuesi, për ciklin e lartë të arsimit bazë, pranë universitetit "Luigj Gurakuqi", Shkodër, në vitin akademik 2008-2009 ……	7748
Vendim i KM nr.1335, datë 1.10.2008	Për hapjen e programeve të studimit, master i nivelit të parë në mësuesi, për ciklin e lartë të arsimit bazë, pranë universitetit "Aleksandër Xhuvani", Elbasan, në vitin akademik 2008-2009	7748
Vendim i KM nr.1336, datë 1.10.2008	Për hapjen e programit të studimit, master i nivelit të parë në mësuesi, për ciklin e lartë të arsimit bazë, pranë universitetit "Fan S. Noli", Korçë, në vitin akademik 2008-2009 ……	7749
Vendim i KM nr.1343, datë 4.6.2008	Për miratimin e procedurave të shpërndarjes së fondit të kompensimit të pronarëve në të holla, për vitin 2008 ……..	7750
Vendim i KM nr.1345, datë 10.10.2008	Për heqjen nga fondi pyjor të sipërfaqeve të dy ngastrave të ekonomisë pyjore "Dhëmbel-Kala", Përmet, që do të përdoren nga "CFF", sh.p.k., për prodhim pllakash guri dekorativ ……	7754
Vendim i KM nr.1346, datë 10.10.2008	Për lejimin e kalimit transit të disa autokolonave ushtarake italiane, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë ……	7756
Vendim i KM nr.1347, datë 10.10.2008	Për lejimin e kalimit transit të një automjeti dhe dy trupave ushtarake sllovene, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë	7757
Vendim i KM nr.1348, datë 10.10.2008	Për disa ndryshime në vendimin nr.160, datë 13.2.2008 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e numrit të punonjësve për vitin 2008 në ministritë dhe institucionet qendrore", të ndryshuar ……	7757
Vendim i KM nr.1354, datë 10.10.2008	Për përcaktimin e kritereve për caktimin e vlerës së dëmit të shkaktuar në fondin kullosor ……	7758

Vendim i KM nr.1355, datë 10.10.2008	Për përcaktimin e objekteve të sektorit minerar, që do të vlerësohen pjesë të sektorëve parësorë në zhvillimin ekonomik të vendit ……	7760
Vendim i KM nr.1356, datë 10.10.2008	Për përcaktimin e autoritetit kontraktues, për dhënien me koncesion të hidrocentralit "Stavec 1", dhe miratimin e bonusit, në procedurën përzgjedhëse konkurruese, që i jepet shoqërisë	7763
Vendim i KM nr.1357, datë 10.10.2008	Për përcaktimin e autoritetit kontraktues, për dhënien me koncesion të hidrocentralit "Domaj", dhe miratimin e bonusit, në procedurën përzgjedhëse konkurruese, që i jepet shoqërisë..	7764
Vendim i KM nr.1358, datë 10.10.2008	Për përcaktimin e autoritetit kontraktues, për dhënien me koncesion të hidrocentralit "Mollaj", dhe miratimin e bonusit, në procedurën përzgjedhëse konkurruese, që i jepet shoqërisë..	7764
Vendim i KM nr.1360, datë 10.10.2008	Për licencimin e institucionit privat të arsimit të lartë "Shkolla e lartë "Illyria"" ……	7765
Udhëzim i MPÇSSHB nr.830, datë 14.4.2008	Për zbatimin e standardeve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror, për fëmijët në institucionet rezidenciale publike dhe jopublike ……	7766
Vendim i KMBSH nr.72, datë 7.10.2008	Për disa ndryshime në rregulloren "Për administrimin e rrezikut nga ekspozimet e mëdha të bankave" ……	7771
Vendim i ERE nr.114, datë 1.10.2008	Për ndryshimin e kushteve të licencës për ushtrimin e aktivitetit të shpërndarjes së energjisë elektrike nga OSSH sh.a.……	7772
Vendim i ERE nr.115, datë 1.10.2008	Për miratimin e licencës për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike ……	7773
Vendim i ERE nr.116, datë 1.10.2008	Mbi vazhdimin e kryerjes së aktivitetit të importit dhe eksportit të energjisë elektrike nga të licencuarit në këto aktivitete për periudhën e mbetur të vlefshmërisë së licencës si aktivitet i tregtimit të energjisë elektrike …….	7773
Vendim i ERE nr.119, datë 9.10.2008	Për licencimin e shoqërisë "Universi" sh.p.k. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike ……	7774
Vendim i ERE nr.120, datë 9.10.2008	Për fillimin e procedurave të shqyrtimit të aplikimit të shoqërisë "Union Eolica Albania" sh.p.k. për kualifikimin e impiantit prodhues (parku eolik Kryevidh, Kavajë), si burim i rinovueshëm energjie ……	7775
Vendim i ERE nr.121, datë 9.10.2008	Për mosfillimin e procedurave për licencimin e shoqërisë "Enpower Albania" sh.p.k. për kryerjen e aktivitetit të tregtimit të energjisë elektrike ……	7775
Vendim i ERE nr.122, datë 10.10.2008	Për disa ndryshime në vendimin nr.110, datë 16.9.2008 "Për licencimin e shoqërisë "Enpower Albania" sh.p.k. në aktivitetin e ndërtimit, instalimit dhe shfrytëzimit të centraleve elektrike me erë, si dhe të prodhimit të energjisë elektrike nga parqet eolike Karaburun dhe Llogara" ……	7776

Vendim i KKRT nr.729, datë 29.9.2008	Për rinovimin e licencës së subjektit televiziv privat vendor “Tv abc” ……	7778
Vendim i KKRT nr.735, datë 29.9.2008	Për rinovimin e licencës së subjektit radiofonik privat vendor “Radio Club Alsion” ……	7778
Vendim i KKRT nr.736, datë 29.9.2008	Për rinovimin e licencës së subjektit radiofonik privat vendor “Radio Star” ……	7779
Vendim i KKRT nr.737, datë 29.9.2008	Mbi vlefshmërinë e licencës së subjektit “Tv kabllor Synej”….	7779
	Kërkesë për shpalljen të vdekur të shtetases Bute Haxhi Memia.	7780

VENDIM
Nr.1321, datë 1.10.2008

PËR TRANSFERIMIN NË PRONËSI TË BASHKISË GRAMSH, TË PRONËS SË PALUAJTSHME, SHTETËRORE, NDËRTESA 2 KATE, ZYRA, GARAZH DHE VENDROJË, TË SHËRBIMIT INFORMATIV TË SHTETIT, NË KËTË QYTET, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.359, DATË 5.6.2003 "PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME, SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI SHËRBIMIT INFORMATIV SHTETËROR", E PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR.431, DATË 11.7.2007 "PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË I TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, BASHKISË GRAMSH, TË QARKUT TË ELBASANIT" TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3/a, 5, 8 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Transferimin në pronësi të bashkisë Gramsh, të pronës së paluajtshme, shtetërore, ndërtesa 2 kate, zyra, garazh dhe vendrojë, aktualisht në përgjegjësi administrimi të Shërbimit Informativ të Shtetit, në këtë qytet, për t'u përdorur për ngritjen e një qendre sociale.
2. Bashkisë së Gramshit i ndalohet ta ndryshojë destinacionin e pronës së përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, ta tjetërsojë ose t'ua japë në përdorim të tretëve.
3. Prona me nr.7 të hiqet nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, e cila i bashkëlidhet vendimit nr.359, datë 5.6.2003 të Këshillit të Ministrave.
4. Prona, ndërtesa 2 kate, zyra, garazh dhe vendrojë, e Shërbimit Informativ të Shtetit, Gramsh, të shtohet në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, e cila i bashkëlidhet vendimit nr.431, datë 11.7.2007 të Këshillit të Ministrave.
5. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe bashkia Gramsh për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

3. FORMULAR PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE
(Të tipit të pronave që inventarizohen si klasa të veçanta)

Institucioni i pushtetit qendror: Shërbimi Informativ i Shtetit
Identifikoi: Xhelal Abedini, kryetar dege, Ylli Goxhaj, ing. ndërtimi
(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)

Bashkia: Gramsh
Supervizoi: Bardhyl Rrapaj, drejtor i Drejtorisë Ekonomike
(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)

Fusha e përdorimit të pronës: Zyra dhe ambiente të tjera ndihmëse
Aprovoi: Petrit Myftari, i ngarkuar ligjor me detyrën e drejtorit të SHISH-it
(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar, tel, firma,vula)

	A		B				C			
Nr. rendor	Zona kadastr.& indeksi i hartës	Nr. pasurisë	Emërtesa e pronës, vendndodhja/ shtrirja gjeografike	Komponentët përbërës të pronës	Adresa/ vendndodhja e komponentëve përbërës	Përmasat e pronës në m^2 ose ml	Funksioni për të cilin përdoret prona	Institucioni/ enti me përgjegjësi administrative	Institucioni/ enti përdorues, statusi juridik i përdorimit	Të dhëna të tjera (shënime të veçanta)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
7			Godinë 2 kate zyra dhe garazh vendrojë Gramsh				Zyra pune ambiente shërbimi	Drejtoria SHISH Elbasan	Kati I-rë e ka në përdorim bashkia	Dhënë me kontratë qiraje me autorizim nr.21, datë 21.3.2001 drejtorit të SHISH Elbasan
7/a				Godinë 2 kate	Gramsh	264				
7/b				Vendrojë	“	9				
7/c				Oborr	“	1050				

VENDIM
Nr.1322, datë 1.10.2008

PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI, NGA AUTORITETI PORTUAL, DURRËS, MINISTRISË SË ARSIMIT DHE SHKENCËS TË KINOKLUBIT "MUJO ULQINAKU", DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.586, DATË 10.9.2004 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR MIRATIMIN E LISTAVE TË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT U KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI SHOQËRIVE ANONIME DHE NDËRMARRJEVE TË SISTEMIT TË TRANSPORTIT DETAR DHE AJROR"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 10, 13 e 14 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Autoriteti Portual, Durrës, Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës të pronës me numër rendor 21, kinoklubi "Mujo Ulqinaku", dhënë sipas vendimit nr.586, datë 10.9.2004 të Këshillit të Ministrave, dhe përcaktuar në formularin nr.3, sipas planvendosjes dhe planimetrisë, që i bashkëlidhen këtij vendimi, për t'u përdorur për nevojat e universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës.
2. Ndryshimi për pronën me numër rendor 21, kinoklubi "Mujo Ulqinaku", Durrës, të reflektohet edhe në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr.586, datë 10.9.2004 të Këshillit të Ministrave.
3. Ngarkohen Ministri i Arsimit dhe Shkencës dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë të ndjekin procedurat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha


Genplani i Kinoklubit
Sh 1:500
1k
2k
2k
2k
10k
10k

PLANIMETRIA E SHESHIT TE NDERTIMIT TE OBJEKTIT: RIKONSTRUKSION DHE NDRYSHIM DESTINACIONI I GODINES SE ISH KINOKLUBIT
VENDODHJA: DURRES

SHK. 1:1000



- Objekti egzistues
- Oborr brenda rrethimit
- Territor publik jashtë aktual të Portit.

SKEMA E VENDOSJES SE SHESHIT
SHK. 1:5000



POZICIONI KADASTRAL
SHK. 1:2000

7735

3. FORMULAR PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE
(Të tipit të pronave që inventarizohen si klasa të veçanta)

Institucioni i pushtetit qendror: Autoriteti Portual Durrës
Identifikoi: Ing ……. (Ing investimesh, Vasil Arbaci (topograf)
(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)
Bashkia/komuna Durrës
Supervizoi: Alqi Loli (ing investimesh)
(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)
Fusha e përdorimit të pronës _____
Aprovoi: Sokol Limani (Drejtor i Autoritetit Portual Durrës)
(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar, tel, firma,vula)

	A		B				C			
Nr. rendor	Zona kadastr.& indeksi i hartës	Nr. pasurisë	Emërtesa e pronës vendndodhja/ shtrirja gjeografike	Komponentët përbërës të pronës	Adresa/ vendndodhja e komponentëve përbërës	Përmasat e pronës në m^2	Funksioni për të cilin përdoret prona	Institucioni/ enti me përgjegjësi administrative	Institucioni/ enti përdorues, statusi juridik i përdorimit	Të dhëna të tjera (shënime të veçanta)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
INVENTARI I KALATAVE, AKUATORIUMIT DHE KANALIT TË HYRJES										
1			Autoriteti Portual Durrës	Kalata 0 me pilota b/arme	Brenda territorit të Portit	988.13	Përpunim anije	Autoriteti Portual Durrës	Autoriteti Portual Durrës	
2				Kalata 1 me pilota b/arme	Lagjja nr.1 Rruga tregtare	2,545.73	Përpunim anije	Autoriteti Portual Durrës	Autoriteti Portual Durrës	
3				Kalata 2 shpunta b/arme		4.01801	Përpunim anije	Autoriteti Portual Durrës	Autoriteti Portual Durrës	
4				Kalata 3 shpunta b/arme		218.40	Përpunim anije	Autoriteti Portual Durrës	Autoriteti Portual Durrës	
5				Kalata 4 shpunta b/arme		2,417.21	Përpunim anije	Autoriteti Portual Durrës	Autoriteti Portual Durrës	
6				Kalata 5 e re me pilota b/arme		3,302.88	Përpunim anije	Autoriteti Portual Durrës	Autoriteti Portual Durrës	
7				Kalata 6 e re me pilota b/arme		3,715.74	Përpunim anije	Autoriteti Portual Durrës	Autoriteti Portual Durrës	
8				Kalatat 7-8 shpunta		5,594.40	Përpunim anije	Autoriteti Portual	Autoriteti Portual	

				metalike				Durrës	Durrës	
9				Kalat 9/A shpunta metalike		1,139.76	Përpunim tragetesh	Autoriteti Portual Durrës	Autoriteti Portual Durrës	
10				Kalat 9/B Pilota b/arme		1,416.15	……..	Autoriteti Portual Durrës	Autoriteti Portual Durrës	
11				K. lindore Pilota b/arme		6,652.98	Përpunim anijesh	Autoriteti Portual Durrës	Autoriteti Portual Durrës	Pjesërisht me qira
12				Kanali hyrës		518,172.00	Kalim anijesh	Autoriteti Portual Durrës	Autoriteti Portual Durrës	
13				Akuatoriumi		628,922.73	Akustim anijesh	Autoriteti Portual Durrës	Autoriteti Portual Durrës	
INVENTARI I NDËRTESAVE I SPECIFIKUAR										
14			8	Mgazina nr.13		2,476.98	mgazinim	Autoriteti Portual Durrës	Autoriteti Portual Durrës	Me qira 2k
15			2	Magazina nr.4-5		6,469.35	magazinim	Autoriteti Portual Durrës	Autoriteti Portual Durrës	1k
16				Kabina elektrike e re		91.53	infrastrukturë	Autoriteti Portual Durrës	Autoriteti Portual Durrës	1k
17			14	Ofiçina komplet		3,081.75	reparte pune	Autoriteti Portual Durrës	Autoriteti Portual Durrës	1+3k
18			13	Parku		1,076.07	shërbim	Autoriteti Portual Durrës	Autoriteti Portual Durrës	1k
19			11	Ofiçina e parkut +vendstrehim		265.33	shërbim	Autoriteti Portual Durrës	Autoriteti Portual Durrës	1k
20			15	Dushe – garderoba		1207.01	zyra të ndryshme	Autoriteti Portual Durrës	Autoriteti Portual Durrës	Pjesërisht me qira 3k
21			17	Klubi “Mujo Ulqinaku”		558.61	nuk përdoret	Autoriteti Portual Durrës	Autoriteti Portual Durrës	1k
22			0	Zjarrfikësat		396.02	repart MNZ	Autoriteti	Autoriteti	2k

								Portual Durrës	Portual Durrës	
23			32	Drejtoria e Portit		539.68	zyra të ndryshme	Autoriteti Portual Durrës	Autoriteti Portual Durrës	2k
24			0	Vendrojë në hyrjen nr.1		8.22	kontroll	Autoriteti Portual Durrës	Autoriteti Portual Durrës	1k
25			0	Zyra e lejeve		18.00	zyrë	Autoriteti Portual Durrës	Autoriteti Portual Durrës	1k
26			33	Drejtoria e doganës		602.21	zyra	Autoriteti Portual Durrës	Autoriteti Portual Durrës	Pjesërisht me qira 2k
27			30	Ish-interklubi		690.60	qendër trajnimi	Autoriteti Portual Durrës	Autoriteti Portual Durrës	Pjesërisht me qira 2k
28			0	Garazh		76.91	garazh	Autoriteti Portual Durrës	Autoriteti Portual Durrës	1k
29			28	Godina në pikën e karburantit		53.28	shërbim	Autoriteti Portual Durrës	Autoriteti Portual Durrës	1k
30			0	Vendrojë hyrja nr.2		11.34	kontroll	Autoriteti Portual Durrës	Autoriteti Portual Durrës	1k

VENDIM
Nr.1323, datë 1.10.2008

PËR KALIMIN NË PRONËSI, NGA ARMO SHA-JA, TIRANË, BASHKISË KUÇOVË, TË ISH-UZINËS SË PËRPUNIMIT TË NAFTËS, KUÇOVË, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.208, DATË 16.4.2004 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME, SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI ARMO SHA-SË"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13 e 15, shkronja "c", të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, dhe të nenit 3 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në pronësi, nga ARMO sh.a.-ja, Tiranë, bashkisë Kuçovë, të pronës me numër rendor 32 "Ish-uzina e përpunimit të naftës, Kuçovë", për ndërtimin e parqeve dhe të zonave rekreative.
2. Prona me numër rendor 32 "Ish-uzina e përpunimit të naftës, Kuçovë", të hiqet nga lista e inventarit, që i bashkëlidhet vendimit nr.208, datë 16.4.2004 të Këshillit të Ministrave.
3. Ky ndryshim të reflektohet në vendimin nr.662, datë 8.10.2004 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të bashkisë Kuçovë, të qarkut të Beratit".
4. Ngarkohen Ministria Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, ARMO sh.a.-ja, bashkia Kuçovë dhe zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

3. FORMULAR PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE
(Të tipit të pronave që inventarizohen si klasa të veçanta)

Institucioni i pushtetit qendror: Shoqëria "ARMO" sh.a. Fier — Identifikoi: Thanas ……..Muçaj, specialist i zyrës së privatizimit (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)

Bashkia: Kuçovë — Supervizoi: Gëzim Shahini, shef i zyrës së privatizimit (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)

Fusha e përdorimit të pronës: Përpunimi dhe tregtimi i nënprodukteve të naftës — Aprovoi: Përparim Hajnaj drejtor i përgjithshëm i shoqërisë "ARMO" sh.a. (emri, mbiemri,pozicioni zyrtar, tel 03423931)

	A		B				C			
Nr. rendor	Zona kadastr.& indeksi i hartës	Nr. pasurisë	Emërtesa e pronës vendndodhja/ shtrirja gjeografike	Komponentët përbërës të pronës	Adresa/ vendndodhja e komponentëve përbërës	Përmasat e pronës në m^2 ose ml	Funksioni për të cilin përdoret prona	Institucioni/ enti me përgjegjësi administrative	Institucioni/ enti përdorues, statusi juridik i përdorimit	Të dhëna të tjera (shënime të veçanta)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
			Uzina e përpunimit të naftës Kuçovë bashkia Kuçovë		Bashkia Kuçovë	250205 m^2	Përpunimi i naftës bruto	MLE Tiranë "ARMO" sh.a. Fier	"ARMO" sh.a. Fier QSHKP Kuçovë	Nuk është në funksionim
32				-Garazh i automjeteve		56 m^2	"	"	"	
				-Këndi kuq		149 m^2	"	"	"	1 kate
				-Zyra e faturimit në dalje		21 m^2	"	"	"	1 kate
				-Magazina e vajit		56 m^2	"	"	"	1 kate
				-Magazina nr.1		173 m^2	"	"	"	1 kate
				-Dushe garderoba		251 m^2	"	"	"	1 kate
				-Mencë		110 m^2	"	"	"	1 kate
				-Ish - muzeu		100 m^2	"	"	"	1 kate
				-Mastika bituminoze		184 m^2	"	"	"	1 kate
				- Laboratori qendror		215 m^2	"	"	"	1 kate
				- Dhoma e rojës		15 m^2	"	"	"	2 kate
				- Dhoma e faturimit		11 m^2	"	"	"	1 kate
				- Dhoma e vjetër e rojës		22 m^2	"	"	"	1 kate
				- Dhoma antidode		30 m^2	"	"	"	1 kate
				- Salla e komandës dhe laboratori i gazit		14 m^2	"	"	"	1 kate
				-Kabinë elektrike dhe salla e pompave		330 m^2	"	"	"	1 kate
				- Kulla e ftohjes		137 m^2	"	"	"	1 kate
				- Garederoba e fabrikës		96 m^2	"	"	"	1 kate

VENDIM
Nr.1324, datë 1.10.2008

PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI NGA MINISTRIA E SHËNDETËSISË, DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË SHËRBIMIT SOCIAL SHTETËROR TË NDËRTESËS SË ISH-SPITALIT, POLIÇAN, DHE PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR.60, DATË 1.2.2006 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI SHËRBIMIT SOCIAL SHTETËROR"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi nga Ministria e Shëndetësisë, Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror të ndërtesës së ish-spitalit, Poliçan.
2. Në listën e formularëve, që i bashkëlidhen vendimit nr.60, datë 1.2.2006 të Këshillit të Ministrave, të shtohet formulari me numrin rendor 32 "Qendra e trajtimit të fëmijëve, që vijnë nga familje në gjakmarrje", në Poliçan, Skrapar, sipas tabelës dhe planimetrisë, që i bashkëlidhen këtij vendimi.
3. Ngarkohen Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Brendshme, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

1. FORMULAR PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE
(Për inventarizimin e pronave të veçanta)

Institucioni i pushtetit qendror: Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta Identifikoi:Ing. Ardian Hasa
Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social
Bashkia: Poliçan Supervizoi: Pashë Dervishi, përgjegjës sektori

Fusha e përdorimit të pronës: shërbime sociale Aprovoi: Vilma Premti, Drejtore e Përgjithshme

	A		B				C			
Nr. rendor	Zona kadastr.& indeksi i hartës	Nr. pasuri së	Lloji i pronës	Emri i pronës, adresa	Sip. totale e pronës (m^2)	Nga sip. totale sa ndërtesa	Funksioni për të cilin përdoret prona	Institucioni/ enti me përgjegjësi administrative	Institucioni/ enti përdorues statusi juridik i përdorimit	Të dhëna të tjera (shënime të veçanta)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
32	K 34-125		Truall ndërtese	Qendra e përkujdesit për fëmijë	3110 m^2	814 m^2	Shërbime për fëmijët	MPÇSSHB Drejt. Përgjith. Shërb. Sociale Shtetërore	Drejt.Përgjith. Shërbimit Sociale Shtetërore	2 Ndërtesa 2 kate dhe 4 katëshe

PLANIMETRIA E KATIT TIP ISH-SPITALI POLIÇAN, S

SH 1:200

$S_{NA} = 814\ m^2$



HARTOI

ING. BUJAR BUNDO

PLAN - VENDOSIA E ISH-SPITALIT

POLICAN S K R A P A R

SH.1:500



Plican,qershor 2008

PUNOI
INXH.Bujar Bunedo

VENDIM
Nr.1325, datë 1.10.2008

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.277, DATË 18.6.1997 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR PËRFITIMET NGA STATUSI I TË VERBËRIT", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 17 të ligjit nr.8098, datë 28.3.1996 "Për statusin e të verbrit", me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pika 3 e vendimit nr.277, datë 18.6.1997 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ndryshohet, si më poshtë vijon:

"3. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror i lëshon personit të verbër librezën e verbërisë, si dokument prove për përfitimin nga ligji nr.8098, datë 28.3.1996 "Për statusin e të verbrit", pas marrjes së vendimit nga Komisioni Mjekësor për Përcaktimin e Verbërisë. Modeli i librezës së verbërisë përcaktohet nga Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1330, datë 1.10.2008

PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË BASHKISË PEQIN, TË QARKUT TË ELBASANIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të bashkisë Peqin, të qarkut të Elbasanit, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj bashkie, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit, territorial dhe administrativ, të bashkisë Peqin, të qarkut të Elbasanit, miratuar me vendimin nr.500, datë 19.7.2006 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në bashkinë Peqin, të qarkut të Elbasanit".

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe bashkia Peqin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Bashkia Peqin Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit

listën e inventarit		
155-158	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
163	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik	Në pronësi
139-145	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive	Në pronësi
1-95	Troje të lira dhe hapësira publike të pazëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji	Në përdorim
96-107, 188-230, 231-334	Infrastrukturë (sheshe, rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike)	Në pronësi
113-138, 172, 173	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik	Në pronësi
169-171	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive)	Në përdorim
146	Prona që përdoren në fushën administrative	Në pronësi

VENDIM
Nr.1331, datë 1.10.2008

PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË STUDIMIT, TË CIKLIT TË DYTË, PRANË UNIVERSITETIT TË TIRANËS, NË VITIN AKADEMIK 2008-2009

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26 e 42 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen, pranë Universitetit të Tiranës, në Fakultetin e Shkencave Sociale, të programeve të studimit, të ciklit të dytë:

i) "Sociologji e Zhvillimeve Shoqërore", në përfundim të të cilit lëshohet diplomë e nivelit të dytë, DND, në sociologjinë e zhvillimeve shoqërore;

ii) "Punë Sociale", me profile:

- Drejtim klinik;
- Organizim komunitar;
- Politikë sociale.

Në përfundim të këtyre programeve do të lëshohen diplomat e mëposhtme:

- Diplomë e nivelit të dytë, DND, në punë sociale, me profil drejtim klinik;
- Diplomë e nivelit të dytë, DND, në punë sociale, me profil organizim komunitar;
- Diplomë e nivelit të dytë, DND, në punë sociale, me profil politikë sociale.

2. Programet e studimeve të ciklit të dytë realizohen me 120 kredite dhe zgjatja normale e tyre është dy vite.

3. Këto programe studimi të fillojnë veprimtarinë mësimore në vitin akademik 2008-2009.

4. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i vitit 2008, miratuar për Universitetin e Tiranës.

5. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Universiteti i Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1332, datë 1.10.2008

PËR HAPJEN E PROGRAMIT TË STUDIMIT, MASTER I NIVELIT TË PARË NË MËSUESI, PËR CIKLIN E LARTË TË ARSIMIT BAZË, PRANË UNIVERSITETIT "ISMAIL QEMALI", VLORË, NË VITIN AKADEMIK 2008-2009

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26 e 42 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen, pranë universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, në Fakultetin e Edukimit, të programit të studimit, master i nivelit të parë në mësuesi, për ciklin e lartë të arsimit bazë, në lëndët "Matematikë-fizikë", në përfundim të të cilit do të lëshohet, diplomë master i nivelit të parë, MNP, në mësuesi, për ciklin e lartë të arsimit bazë, në lëndët matematikë-fizikë.
2. Ky program studimi realizohet me 60 kredite dhe zgjatja normale e tij është një vit.
3. Ky program studimi të fillojë veprimtarinë mësimore në vitin akademik 2008-2009.
4. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i vitit 2008, miratuar për universitetin "Ismail Qemali", Vlorë.
5. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe universiteti "Ismail Qemali", Vlorë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1333, datë 1.10.2008

PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË STUDIMIT, MASTER I NIVELIT TË PARË NË MËSUESI, PËR CIKLIN E LARTË TË ARSIMIT BAZË, PRANË UNIVERSITETIT "LUIGJ GURAKUQI", SHKODËR, NË VITIN AKADEMIK 2008-2009

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26 e 42 të ligjit nr.9741, datë

21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen, pranë universitetit “Luigj Gurakuqi”, Shkodër, në Fakultetin e Shkencave të Edukimit, të programeve të mëposhtme të studimit, master i nivelit të parë në mësuesi, për ciklin e lartë të arsimit bazë:

a) Në lëndën “Gjuhë italiane”, në përfundim të të cilit do të lëshohet diplomë, master i nivelit të parë, MNP, në mësuesi, për ciklin e lartë të arsimit bazë, në lëndën gjuhë italiane;

b) Në lëndën “Gjuhë frënge”, në përfundim të të cilit do të lëshohet diplomë, master i nivelit të parë, MNP, në mësuesi, për ciklin e lartë të arsimit bazë, në lëndën gjuhë frënge.

2. Këto programe studimi realizohen me 60 kredite dhe zgjatja normale e tyre është një vit.

3. Këto programe studimi të fillojnë veprimtarinë mësimore në vitin akademik 2008-2009.

4. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i vitit 2008, miratuar për universitetin “Luigj Gurakuqi”, Shkodër.

5. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe universiteti “Luigj Gurakuqi”, Shkodër, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1335, datë 1.10.2008

PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË STUDIMIT, MASTER I NIVELIT TË PARË NË MËSUESI, PËR CIKLIN E LARTË TË ARSIMIT BAZË, PRANË UNIVERSITETIT “ALEKSANDËR XHUVANI”, ELBASAN, NË VITIN AKADEMIK 2008-2009

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26 e 42 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen, pranë universitetit “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan, në Fakultetin e Shkencave të Edukimit, të programeve të mëposhtme të studimit, master i nivelit të parë në mësuesi, për ciklin e lartë të arsimit bazë:

a) Në lëndët “Matematikë-Fizikë”, në përfundim të të cilit do të lëshohet diplomë, master i nivelit të parë, MNP, në mësuesi, për ciklin e lartë të arsimit bazë, në lëndët matematikë-fizikë;

b) Në lëndët “Matematikë-Informatikë”, në përfundim të të cilit do të lëshohet diplomë, master i nivelit të parë, MNP, në mësuesi, për ciklin e lartë të arsimit bazë, në lëndët matematikë-informatikë;

c) Në lëndët “Histori-Gjeografi”, në përfundim të të cilit do të lëshohet diplomë, master i nivelit të parë, MNP, në mësuesi, për ciklin e lartë të arsimit bazë, në lëndët histori-gjeografi.

2. Këto programe studimi realizohen me 60 kredite dhe zgjatja normale e tyre është një vit.

3. Këto programe studimi të fillojnë veprimtarinë mësimore në vitin akademik 2008-2009.

4. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i vitit 2008, miratuar për universitetin “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan.

5. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe universiteti “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1336, datë 1.10.2008

PËR HAPJEN E PROGRAMIT TË STUDIMIT, MASTER I NIVELIT TË PARË NË MËSUESI, PËR CIKLIN E LARTË TË ARSIMIT BAZË, PRANË UNIVERSITETIT "FAN S. NOLI", KORÇË, NË VITIN AKADEMIK 2008-2009

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26 e 42 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen, pranë universitetit "Fan S. Noli", Korçë, në Fakultetin e Mësuesisë, të programit të studimit, master i nivelit të parë në mësuesi, për ciklin e lartë të arsimit bazë, në lëndët "Matematikë-Fizikë", në përfundim të të cilit do të lëshohet diplomë, master i nivelit të parë, MNP, në mësuesi, për ciklin e lartë të arsimit bazë, në lëndët matematikë-fizikë.
2. Ky program studimi realizohet me 60 kredite dhe zgjatja normale e tij është një vit.
3. Ky program studimi të fillojë veprimtarinë mësimore në vitin akademik 2008-2009.
4. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i vitit 2008, miratuar për universitetin "Fan S. Noli", Korçë.
5. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe universiteti "Fan S. Noli", Korçë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1343, datë 4.6.2008

PËR MIRATIMIN E PROCEDURAVE TË SHPËRNDARJES SË FONDIT TË KOMPENSIMIT TË PRONARËVE NË TË HOLLA, PËR VITIN 2008

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 17 të ligjit nr.9235, datë 29.7.2005 "Për kthimin dhe kompensimin e pronës", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Subjektet e shpronësuara, prona e të cilave është e njohur e gjitha për kompensim, dhe që nuk kanë përfituar nga kompensimet e mëparshme, kompensohen, sipas radhës kronologjike, të përcaktuar nga numri i vendimit dhe data e tij, sipas viteve.

2. Kompensimi të bëhet vetëm për deri 200 (dyqind) m^2 të sipërfaqes së caktuar për kompensim, në bazë të çmimit të përcaktuar në hartën e vlerës së miratuar, sipas vendndodhjes së pronës, që kompensohet.

3. Subjektet, që kanë depozituar kërkesat e tyre në vitet 2006 dhe 2007 dhe vërtetojnë kryerjen e pagesës, nuk paguajnë tarifën e aplikimit për vitin 2008.

4. Subjekti duhet të plotësojë dhe të paraqesë, pranë zyrës së AKKP-së në qendër, dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Kërkesën për kompensim financiar, sipas formularit 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi;

b) Deklaratën për pranimin e kritereve për kompensim, sipas vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave, dhe kushtet e tjera, që lidhen me kriteret, sipas formularit 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi;

c) Vendimin e Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ose të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, për njohjen dhe kompensimin e pronës, së bashku me planvendosjen përkatëse;

ç) Dëshminë e trashëgimisë;

d) Prokurën e posaçme, të nënshkruar nga të gjithë trashëgimtarët e ligjshëm, ku si tagër i nevojshëm të jetë edhe e drejta për të tërhequr vlerën financiare, në emër të subjektit të shpronësuar;

dh) Fotokopjen e noterizuar të dokumentit të identifikimit (letërnjoftim, pasaportë) ose certifikatën e lindjes së personit, që ka prokurën e përfaqësimit;

e) Mandatpagesën.

5. Zyra e AKKP-së në qendër, në bashkëpunim me zyrat rajonale, shqyrton dokumentacionin e subjekteve, që kërkojnë kompensim.

5.1 Zyra rajonale e kthimit dhe kompensimit të pronave kryen veprimet e mëposhtme:

a) Verifikon dosjen dhe vendimin përkatës, të dhënë nga Komisioni i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ose Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, si dhe vendimet e tjera për këtë subjekt të shpronësuar.

b) Kërkon nga zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, që, brenda 10 ditëve, të konfirmojnë të dhënat për:

i) vlefshmërinë e regjistrimit të vendimit përkatës në ZRPP;

ii) verifikimin e ndryshimit të gjendjes juridike të pronës nga çasti i daljes së vendimit të paraqitur nga subjekti përkatës;

iii) verifikimin e regjistrimit dhe të ushtrimit të së drejtës së parablerjes;

c) Kërkon nga SAMT-ja e qarkut përkatës përfitimin e mundshëm të tokës bujqësore sipas ligjit nr.7501, datë 19.7.1991 "Për tokën".

ç) Verifikon në *database* të gjitha vendimet për këtë subjekt, për identifikimin e vendimeve për kthim dhe kompensim të tij;

d) Kryen verifikimin në terren të gjendjes së pronës dhe mban procesverbalin përkatës;

dh) Përgatit planvendosjen e pronës dhe cakton:

i) në hartën e vlerës, zonën, ku ndodhet prona;

ii) në bashkëpunim me subjektin e shpronësuar, pjesën e pronës, që kërkohet për t'u kompensuar, kur prona është mbi 200 (dyqind) m^2 dhe i kërkon personit, që ka prokurën e përfaqësimit, të nënshkruajë për pjesën, që kompensohet;

e) Llogarit vlerën e sipërfaqes, që kompensohet;

ë) Përgatit relacionin, ku shpjegohen me hollësi, për secilin subjekt kërkues të kompensimit:

i) Vlefshmëria e vendimit të paraqitur nga subjekti;

ii) Vendimet e tjera, që vërtetojnë njohje dhe kthime të tjera të pronës për subjektin përkatës, shoqëruar me kopje të tyre;

iii) konfirmimet e zyrës vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme;

iv) vlerësimin e pronës për kompensim.

5.2 Zyra e Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave në qendër shqyrton dokumentacionin e zyrave rajonale të kthimit dhe kompensimit të pronave dhe:

a) përgatit vlerësimin ligjor të kompensimit;

b) harton relacionin përkatës;

c) nxjerr vendimin për kompensim ose jo të subjektit të shpronësuar;

ç) i dërgon subjektit të shpronësuar, Avokatit të Shtetit dhe zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme kopje të vendimeve të marra, për t'u dhënë mundësi të ushtrojnë kompetencat ligjore;

d) shpall listën e subjekteve fituese;

dh) kryen veprimet me thesarin dhe bankën për kalimin e fondit të kompensimit në të holla në emër të subjektit të shpronësuar, përfitues të kompensimit, apo përfaqësuesit të tij me prokurë, në përputhje me procedurat për zbatimin e Buxhetit të Shtetit.

6. Procesi i regjistrimit/pranimit të kërkesave për kompensim fillon 5 ditë pas datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi dhe vazhdon 30 ditë.

7. I gjithë procesi i trajtimit të kërkesave të subjekteve të shpronësuara duhet të kryhet në përputhje me këtë vendim dhe me afatin ligjor, të përcaktuar në nenin 17/2 të ligjit nr.9235, datë 29.7.2005 "Për kthimin dhe kompensimin e pronës", të ndryshuar.

8. Paraqitja e të dhënave të rreme ose fshehja e tyre nga subjektet e shpronësuara, në zbatim të këtij vendimi, sjell përjashtimin e menjëhershëm të këtyre subjekteve nga procedura e kompensimit financiar dhe i ngarkon ata me përgjegjësi penale, sipas ligjit.

9. Ngarkohen Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave dhe zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Formulari tip 1

KËRKESË
PËR KOMPENSIMIN E PRONËS

Drejtuar: Agjencisë së Kthimit dhe Kompesimit të Pronave

Data e paraqitjes së kërkesës ___/___/2008

Subjekti i shpronësuar:

…….. …… ……..
Emri Atësia Mbiemri

Personi me prokurë që paraqet kërkesën:

…….. …… ……..
Emri Atësia Mbiemri

Adresa e personit me prokurë:

…….. …… ……..
Qarku Rrethi Qyteti/Fashti

…….. …… ……..
Lagja Rruga Nr.i banesës

…….. …… ……..
Telafon Celular e-mail

Kërkoj **kompensimin e pronës me të holla**, sipas kritereve të përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave nr._____, datë ____/____/2008 "Për miratimin e procedurave të ndarjes së fondit të kompensimit në të holla, për vitin 2008".

Kërkuesi
……..
Emri, atësia, mbiemri

……..
Nënshkrimi

Shënim. Ky formular është dokument zyrtar. Paraqitja e të dhënave të rreme ose fshehja e tyre passjell përjashtimin e menjëhershëm nga çdo procedurë e mëtejshme, si dhe përgjegjësi penale sipas ligjit.

Formulari tip 2

DEKLARATË

Personi me prokurë që paraqet kërkesën:

…….. …… ……..
Emri Atësia Mbiemri

Adresa e personit me prokurë:

…….. …… ……..
Qarku Rrethi Qyteti/fshati

…….. …… ……..
Lagja Rruga Nr.i banesës

…….. …… ……..
Telefon Celular e-mail

Në emër të trashëgimtarëve të subjektit të shpronësuar, sipas prokurorisë së posaçme të bashkëlidhur, deklaroj se:

1. Në rast se nuk shpallem fitues, sipas kritereve të përcaktuar në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.____, datë ___/___2008 "Për miratimin e procedurave të shpërndarjes së fondit të kompensimit në të holla, për vitin 2008", tërhiqen nga kërkesa e paraqitur për kompensimin në të holla për vitin 2008.

2. Heq dorë nga e drejta e parablerjes për sipërfaqen e kompensuar, në rast se shpallem fitues në këtë aplikim.

3. Nuk kam fituar nga kompensimet e mëparshme, si dhe nuk kam përfituar tokë nga zbatimi i ligjit nr.7501, datë 19.7.1991 "Për tokën".

4. Nuk jam në proces gjyqësor, apo proces shqyrtimi të një ankimi administrativ në lidhje me pronën objekt kompensimi.

Kjo deklaratë i bashkëlidhet kërkesës nr._____, datë ____/_____/2008, për kompensim në të holla për vitin 2008.

Deklarues
Përfaqësues me prokurë

……..
Emri, atësia, mbiemri

……..
Nënshkrimi

Shënim. Ky formular është dokument zyrtar. Paraqitja e të dhënave të rreme ose fshehja e tyre passjell përjashtimin e menjëhershëm nga çdo procedurë e mëtejshme, si dhe përgjegjësi penale sipas ligjit.

VENDIM
Nr.1345, datë 10.10.2008

PËR HEQJEN NGA FONDI PYJOR TË SIPËRFAQEVE TË DY NGASTRAVE TË EKONOMISË PYJORE ""DHËMBEL-KALA", PËRMET", QË DO TË PËRDOREN NGA "CFF" SHPK, PËR PRODHIM PLLAKASH GURI DEKORATIV

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës "b" të pikës 1 të nenit 17 të ligjit nr.9385, datë 4.5.2005 "Për pyjet dhe shërbimin pyjor", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe të Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Sipërfaqet e ngastrave 98/a e 99/a, të ekonomisë pyjore ""Dhëmbel-Kala", Përmet", që do të përdoren nga "CFF" sh.p.k., për prodhim guri dekorativ, në një sipërfaqe, gjithsej, 5 ha, të hiqen nga fondi pyjor kombëtar dhe të çregjistrohen nga zëri kadastral "Pyll", sipas tabelës 1 dhe hartës përkatëse, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Përcaktimin në terren dhe në hartë të kufijve të rinj të fondit pyjor kombëtar, pas heqjes së sipërfaqeve të ngastrave, të përmendura në pikën 1 të këtij vendimi, si dhe përfundimin e procedurave për pagesat, në përputhje me vendimin nr.391, datë 21.6.2006 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave".

3. "CFF" sh.p.k., brenda 2 vjetëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, të pyllëzojë, me

shpenzimet e veta, 5 ha me pyje, sipas ngastrave të përcaktuara nga drejtoria e shërbimit pyjor.

4. Ngarkohet Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha



TABELA NR.1
NGASTRA QË KËRKOHEN PËR HEQJE NGA FONDI PYJOR

Nr.	Ekonomia pyjore	Ngastra, n/ngastra	Kërkuar ha	Zëri kadastral	Forma e qeverimit	Funksioni	Pronësia	Objekti
1	EP Dhëmbel-Kala	98/a	4.625	Pyll	Shkurre	Prodhues	Publike	Karrier guri
2	EP Dhëmbel-Kala	99/a	0.375	Pyll	shkurre	prodhues	publike	Karrier guri
			5.00					

VENDIM
Nr.1346, datë 10.10.2008

PËR LEJIMIN E KALIMIT TRANSIT TË DISA AUTOKOLONAVE USHTARAKE ITALIANE, PËRMES TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 16, pika 2, 17, 18 e 19, të ligjit nr.9363, datë 24.3.2005 "Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit", me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e kalimit transit, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, në itinerarin Qafë-Thanë - Porti i Durrësit, në datën 16 tetor 2008, të një autokolone ushtarake italiane, të përbërë nga 7 (shtatë) automjete dhe 16 (gjashtëmbëdhjetë) trupa.

2. Lejimin e kalimit transit, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, në itinerarin Porti i Durrësit - Qafë-Thanë, në datën 17 tetor 2008, të një autokolone ushtarake italiane, të përbërë nga 18 (tetëmbëdhjetë) automjete dhe 38 (tridhjetë e tetë) trupa.

3. Pika e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë për datën 16 tetor 2008 është pika e kalimit të kufirit Qafë-Thanë dhe pika e daljes është pika e kalimit të kufirit Porti i Durrësit.

Pika e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë për datën 17 tetor 2008 është pika e kalimit të kufirit Porti i Durrësit dhe pika e daljes është pika e kalimit të kufirit Qafë-Thanë.

4. Procedurat për hyrjen, qëndrimin dhe daljen e këtyre trupave në Republikën e Shqipërisë janë parashikuar në marrëveshjen, ndërmjet palëve të Traktatit të Atlantikut të Veriut, për statusin e forcave, nënshkruar në Londër, më 19 qershor 1951, të marrëveshjes, ndërmjet shteteve palë në Traktatin e Atlantikut të Veriut dhe shteteve të tjera, që marrin pjesë në Partneritetin për Paqe, përsa i përket statusit të forcave të tyre, nënshkruar në Bruksel, më 10 janar 1994, si dhe të protokollit shtesë, për marrëveshjen, ndërmjet shteteve palë në Traktatin e Atlantikut të Veriut dhe të shteteve të tjera pjesëmarrëse në Partneritetin për Paqe, përsa i përket statusit të forcave të tyre, ratifikuar me ligjin nr.8034, datë 22.11.1995.

5. Autokolonat ushtarake italiane, gjatë itinerarit të lëvizjes nëpër territorin e Republikës së Shqipërisë, të shoqërohen nga njësi të armatosura të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

6. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1347, datë 10.10.2008

PËR LEJIMIN E KALIMIT TRANSIT TË NJË AUTOMJETI DHE DY TRUPAVE USHTARAKE SLLOVENE, PËRMES TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 16, pika 2, 17, 18 e 19, të ligjit nr.9363, datë 24.3.2005 "Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit", me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e kalimit transit të 1 (një) automjeti ushtarak slloven dhe 2 (dy) trupave ushtarake sllovene, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, në itinerarin Porti i Durrësit-Qafë-Thanë, në datë 13 tetor 2008.

2. Procedurat për hyrjen, qëndrimin dhe daljen e këtyre trupave në/nga Republika e Shqipërisë janë parashikuar në marrëveshjen, ndërmjet palëve të Traktatit të Atlantikut të Veriut, për statusin e forcave, nënshkruar në Londër, më 19 qeshor 1951, të marrëveshjes, ndërmjet shteteve palë në Traktatin e Atlantikut të Veriut dhe shteteve të tjera, që marrin pjesë në Partneritetit për Paqe, përsa i përket statusit të forcave të tyre, nënshkruar në Bruksel, më 10 janar 1994, si dhe të protokollit shtesë për marrëveshjen, ndërmjet shteteve palë në Traktatin e Atlantikut të Veriut dhe të shteteve të tjera, pjesëmarrëse në Partneritetin për Paqe, përsa i përket statusit të forcave të tyre ratifikuar me ligjin nr.8034, datë 22.11.1995.

3. Automjeti dhe trupat ushtarake sllovene, gjatë itinerarit të lëvizjes nëpër territorin e Republikës së Shqipërisë, të shoqërohen nga njësi të armatosura të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

4. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1348, datë 10.10.2008

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.160, DATË 13.2.2008 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE «PËR PËRCAKTIMIN E NUMRIT TË PUNONJËSVE PËR VITIN 2008 NË MINISTRITË DHE INSTITUCIONET QENDRORE», TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 10 të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.160, datë 13.2.2008 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto ndryshime:

1. Ministrisë së Brendshme, në numrin e punonjësve të miratuar për vitin 2008, t'i shtohen edhe 60 punonjës, për krijimin e komisioneve vendore të vlerësimit të titujve të pronësisë. Numri i përgjithshëm i punonjësve të kësaj ministrie, për periudhën tetor-dhjetor 2008, bëhet 13 125.

2. Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, në numrin e punonjësve, të miratuar për vitin 2008, t'i shtohen edhe 5 punonjës, për krijimin e sekretariatit teknik të komisionit qeveritar të tokës. Numri i përgjithshëm i punonjësve të kësaj ministrie, për periudhën tetor-dhjetor 2008, bëhet 2 114.

3. Numri i përgjithshëm i punonjësve buxhetorë, për vitin 2008, për periudhën tetor-dhjetor 2008, bëhet 104 396 veta, i paraqitur në lidhjen nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

4. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Brendshme dhe Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1354, datë 10.10.2008

PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE PËR CAKTIMIN E VLERËS SË DËMIT TË SHKAKTUAR NË FONDIN KULLOSOR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 33 të ligjit nr.9693, datë 19.3.2007 "Për fondin kullosor", me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Zhdëmtimin në masë të plotë dhe të njëhershëm të dëmit të shkaktuar në fondin kullosor. Zhdëmtimi përfshin:

a) pagesën e vlerës reale të dëmit, shkaktuar kullotës, livadhit ose objekteve infrastrukturore;

b) koston për rikthimin e situatës në gjendjen e mëparshme.

2. Pagimi i dëmit bëhet në bazë të aktzhdëmtimit, të nënshkruar nga drejtori i drejtorisë së shërbimit pyjor ose nga kryetari i njësisë së qeverisjes vendore, kur dëmi ka ndodhur në kullota e livadhe komunale.

3. Aktzhdëmtimi mbështetet në dokumentacionin standard, si procesverbali i këqyrjes së vendit apo i objektit të dëmtuar, aktkontrolli dhe aktverifikimi për vlerësimin e dëmit, të cilët hartohen nga inspektorët e Policisë Pyjore, nga specialistët e drejtorisë së shërbimit pyjor, në territorin e së cilës është kryer dëmi ose nga organi kontrollues i njësisë së qeverisjes vendore, kur dëmi është kryer në kullotat e livadhet komunale. Këto dokumente hartohen në kohën e vënies re të dëmit.

4. Për përcaktimin e vlerës së një dëmi të shkaktuar në kullota apo në livadhe, drejtoria përkatëse e shërbimit pyjor ose njësia e qeverisjes vendore mban parasysh:

a) Sipërfaqen e kullotës apo të livadhit, e shprehur në njësinë fizike (m^2), duke evidentuar tipin e kullotës dhe natyrën e dëmtimit të mbulesës barishtore të saj;

b) Shkallën e dëmtimit të sipërfaqes së dëmtuar në raport me sipërfaqen e përgjithshme të saj, të shprehur në %;

c) Mënyrën dhe mjetet konkrete, me të cilat është shkaktuar dëmi;

ç) Sasinë e barit të kullotave e livadheve, të bimëve mjekësore, tanifere, eterovajore e prodhimeve të tjera të dëmtuara, në përputhje me të dhënat e përcaktuara për çdo ngastër nga plani i mbarështimit të kullotave;

d) Dëmtimin e llojeve me status të mbrojtur: dru farorë, lloje të kërcënuara ose në rrezik zhdukjeje, fidanë në fidanishte, gërmoplazme (fruta, fara) dhe parcela eksperimentale;

dh) Tabelën nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

5. Për vlerësimin e dëmit në secilin element përbërës të infrastrukturës së kullotave e livadheve, drejtoria përkatëse e shërbimit pyjor ose njësia e qeverisjes vendore përcakton:

a) objektin konkret të dëmtuar, sipas përcaktimeve të pikës 6 të këtij vendimi;

b) shkallën e dëmtimit të objektit;

c) koston financiare të objektit të dëmtuar;

ç) shpenzimet, që nevojiten për ta riparuar e rikthyer në gjendjen e mëparshme.

6. Dëmtuesi i objekteve infrastrukturore të kullotave (rrugë, ura, tombino, prita malore, lera,

çezma, korita, kanale, shenja kufi dëftuese, tabela, rrethime me tel e drurë, ngrehina etj.) në marrëveshje, me shkrim, me drejtorinë përkatëse të shërbimit pyjor, merr përsipër ta riparojë vetë dëmin, deri në kthimin e situatës në gjendjen e mëparshme.

7. Në rastin e përshkruar në pikën 6 të këtij vendimi, riparimi kryhet nën kontrollin e drejtorisë së shërbimit pyjor, në territorin e së cilës ka ndodhur dëmtimi, e cila, në përfundim të riparimit, e merr në dorëzim objektin e riparuar. Në rast se riparimi nuk është kryer sipas kushteve të përcaktuara në marrëveshje, dëmtuesi detyrohet të shpërblejë vlerën e dëmit. Për objektet infrastrukturore të kullotave komunale, këto procedura zbatohen nga njësia organizative e qeverisjes vendore.

8. Pagesa derdhet në llogarinë bankare të drejtorisë së shërbimit pyjor ose të njësisë së qeverisjes vendore, kur dëmi është shkaktuar në kullotat e livadhet komunale.

9. Të ardhurat nga shpërblimi i dëmit përdoren nga drejtoria përkatëse e shërbimit pyjor sipas vendimit nr.432, datë 28.6.2006 të Këshillit të Ministrave "Për krijimin dhe administrimin e të ardhurave, që krijojnë institucionet buxhetore".

10. Ngarkohen Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe komunat e bashkitë, që kanë, në pronësi apo në përdorim, kullota e livadhe, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Tabela 1
E SHPËRBLIMIT TË DËMEVE TË SHKAKTUARA NË FONDIN KULLOSOR

	Lloji i dëmit	**Njësia e matjes**	**Vlefta e dëmit për njësi në lekë**
1	A. Dëmtime të parikthyeshme të sipërfaqes kullosore Dëmtim i pakthyeshëm i sipërfaqes së kullotave dhe livadheve nga ndërtimet e instalimet e pamiratuara për: miniera, stacione energjetike, linja elektrike, telegrafike televizive, gazsjellës, naftësjellës, linja tensioni të lartë, ujësjellës, kanale, rrugë, shtëpi banimi, objekte shërbimi, nxjerrje gurësh, zhavorri, ngritje furra gëlqere, kamina e të tjera të kësaj natyre	m^2	1000
1	B. Dëmtime të rikthyeshme Dëmtim i sipërfaqes së kullotës dhe livadhit me anë të punimit:		
	a) me mjete të mekanizuara	m^2	500
	b) me krahë	m^2	300
2	Dëmtimi i sipërfaqeve të kullotës dhe livadhit nga instalimi i vathave të pa lëvizshme (me qëndrim bagëtie mbi 6 ditë)	m^2	100
3	Dëmtimi i sipërfaqes së kullotës dhe livadhit nga depozitimi i mbeturinave sipas nenit 23 të ligjit nr.9693, datë 19.3.2007 "Për fondin kullosor" jashtë vendeve të depozitimit	m^2	500
4	Dëmtim nga futja për kullotje e bagëtive në kullota dhe livadhe jashtë afateve të kontratës: A. Para sezonit të kullotjes 1. Në kullotat dhe livadhet verore:		
	- për bagëtitë e imëta,	Krerë	10
	- për bagëtitë e trasha	Krerë	20
	2. Në kullotat dhe livadhet dimërore:		
	- për bagëtitë e imëta,	Krerë	20
	- për bagëtitë e trasha	Krerë	50
5	B. Mbas sezonit të kullotjes 1. Në kullotat dhe livadhet verore:		
	për bagëtitë e imëta,	Krerë	50
	për bagëtitë e trasha.	Krerë	100
	2. Në kullotat dhe livadhet dimërore:		
	- për bagëtitë e imëta,	Krerë	30

	- për bagëtitë e trasha	Krerë	50
6	Dëmtim i kullotës dhe livadhit nga kullotja pa kontratë brenda sezonit të kullotjes, për çdo ditë të veçantë kullotjeje:		
	- për bagëtitë e imëta,	Krerë	30
	- për bagëtitë e trasha	Krerë	50
7	Shfrytëzimi i kullotës dhe livadhit duke futur krerë mbi ato të përcaktuara në kontratë:		
	- për bagëtitë e imëta,	Krerë	20
	- për bagëtitë e trasha	Krerë	50
8	Kositja e kullotës ose livadhit pa kontratë:		
	në kullotat natyrore,	m^2	50
	- në parcelat farore,	m^2	100
	- në parcelat eksperimentale	m^2	200
9	Dëmtim i kullotës ose livadhit:		
	kur kryhen punime përmirësuese	m^2	100
	- në parcelat farore	m^2	250
	- në parcelat eksperimentale	m^2	500
10	Dëmtimi i kullotës dhe livadhit nga ngritja e kampingjeve dhe objekteve të tjera të lëvizshme	m^2	100
11	Dëmtimi i kullotës dhe livadhit nga zjarret	m^2	200

VENDIM
Nr.1355, datë 10.10.2008

PËR PËRCAKTIMIN E OBJEKTEVE TË SEKTORIT MINERAR, QË DO TË VLERËSOHEN PJESË TË SEKTORËVE PARËSORË NË ZHVILLIMIN EKONOMIK TË VENDIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4, pika 3, e 5, të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 "Për koncesionet", me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përfshirjen në listën e aseteve, që do të jepen me koncesion, me çmimin simbolik 1 euro, të objekteve: "Miniera e kromit, Kalimash", "Miniera e kromit, Vlahna", "Fabrika e pasurimit të kromit, Kalimash" dhe "Fabrika e pasurimit të bakrit, Golaj", të përcaktuara më hollësisht në shtojcën nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Objektet e përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi, të cilat vlerësohen se paraqesin interes për investime private, në fushën e veprimtarisë minerare, të jepen me koncesion, duke filluar me çmimin simbolik 1 euro.

3. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës është autoriteti kontraktues për dhënien me koncesion të këtyre objekteve.

4. Shpenzimet për realizimin e procedurave për dhënien me koncesion të përballohen nga ofertuesi fitues.

5. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

SHTOJCA 1
ZONA E KONCESIONIT PËR MASIVIN VERILINDOR TË KROMIT PËRFSHIN MINIERËN E KALIMASHIT, FABRIKËN E PASURIMIT TË KROMIT, KALIMASH DHE MINIERËN E VLLAHNËS

MINIERA E KROMIT KALIMASH, FABRIKA E PASURIMIT KALIMASH

Sipërfaqja totale e fushës minerare të trupave xeheror që përfshin miniera e Kalimashit (Kalimash 1 – Përroi i Batrës + Kalimash 2 + Kalimash 3, ku përfshihet dhe fabrika e pasurimit të kromit Kalimash) është 7.05 km^2 dhe përcaktohet sipas kontureve koordinative të tabelës 1.

Tabela 1. Koordinatat e kontureve të zonës (në të cilën përfshihen të gjithë trupat minerare dhe fabrika e pasurimit të kromit Kalimash)

Pika e konturit	Koordinata Y	Koordinata X
1	44 38 500	46 57 000
2	44 38 500	46 58 000
3	44 40 000	46 59 000
4	44 43 000	46 59 000
5	44 43 000	46 56 700
6	44 42 000	46 56 700
7	44 42 000	46 58 000
8	44 41 000	46 58 000
9	44 40 000	46 57 000

Shënim. Zona minerare e koncesionit është e gjitha brenda lejes minerare të zbulimit (mineral kromi) nr.1125 të subjektit "Jab resources" sh.p.k., në kushtet specifike të së cilës janë përjashtuar objektet ekzistuese të kromit, pra zona e koncesionit.

MINIERA E KROMIT VLLAHNË

Sipërfaqja totale e fushës minerare të trupave xeheror për zonën e Vllahnës është 1.92 km^2, brenda kësaj zone është një leje minerare (leja minerare nr.769 me një sipërfaqe prej 0.1 km^2) si rezultat sipërfaqja e lirë për koncesion është 1.82 km^2 dhe përcaktohet sipas kontureve koordinative të tabelës 2 dhe 3.

Tabela 2. Koordinatat e kontureve të zonës Vllahnë (në të cilën përfshihen të gjithë trupat minerare dhe koordinatat e lejes minerare nr.769)

Pika e konturit	Koordinata Y	Koordinata X
1	44 55 600	46 77 800
2	44 55 600	46 78 200
3	44 56 400	46 78 200
4	44 56 400	46 78 600

5	44 57 200	46 78 600
6	44 57 200	46 76 600
7	44 56 400	46 76 600
8	44 56 400	46 77 800

Shënim. Zona minerare e koncesionit është e gjitha brenda lejes minerare të zbulimit (mineral FeNi) nr.1133 të subjektit ADI sh.a., në kushtet specifike të së cilës janë përjashtuar objektet ekzistuese të kromit, pra zona e koncesionit.

Tabela 3. Koordinatat e konturit të lejes minerare nr.769 (Subjekti "Neza-2004"sh.p.k., leje shfrytëzimi kromi)

X = 4456810.0000	Y = 4677270.0000	Z = 0.0000
X = 4456940.0000	Y = 4677240.0000	Z = 0.0000
X = 4457040.0000	Y = 4677280.0000	Z = 0.0000
X = 4457040.0000	Y = 4677320.0000	Z = 0.0000
X = 4456935.0000	Y = 4677320.0000	Z = 0.0000
X = 4456830.0000	Y = 4677320.0000	Z = 0.0000
X = 4456835.0000	Y = 4677425.0000	Z = 0.0000
X = 4456840.0000	Y = 4677530.0000	Z = 0.0000
X = 4456940.0000	Y = 4677510.0000	Z = 0.0000
X = 4456950.0000	Y = 4677350.0000	Z = 0.0000
X = 4457120.0000	Y = 4677360.0000	Z = 0.0000
X = 4457140.0000	Y = 4677220.0000	Z = 0.0000
X = 4457160.0000	Y = 4677080.0000	Z = 0.0000
X = 4457130.0000	Y = 4677060.0000	Z = 0.0000
X = 4457090.0000	Y = 4677030.0000	Z = 0.0000
X = 4457050.0000	Y = 4677040.0000	Z = 0.0000
X = 4456940.0000	Y = 4677140.0000	Z = 0.0000
X = 4456830.0000	Y = 4677240.0000	Z = 0.0000
X = 4456670.0000	Y = 4677270.0000	Z = 0.0000
X = 4456680.0000	Y = 4677300.0000	Z = 0.0000

FABRIKA E PASURIMIT TË BAKRIT GOLAJ

Sipërfaqja totale e fabrikës së pasurimit të bakrit Golaj është 0.0615 km^2 dhe përcaktohet sipas kontureve koordinative të tabelës 4.

Tabela 4. Koordinatat e kontureve të fabrikës së pasurimit të bakrit Golaj

Pika e konturit	Koordinata Y	Koordinata X
1	44 49 627	46 78 163
2	44 49 701	46 78 229
3	44 50 007	46 78 276
4	44 50 002	46 78 149
5	44 49 962	46 78 026
6	44 49 640	46 78 122

VENDIM

Nr.1356, datë 10.10.2008

PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, PËR DHËNIEN ME KONCESION TË HIDROCENTRALIT "STAVEC 1", DHE MIRATIMIN E BONUSIT, NË PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE KONKURRUESE, QË I JEPET SHOQËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 3, e 23, pika 3, shkronja "b", të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 "Për koncesionet", me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autoriteti kontraktues për kryerjen e procedurave ligjore, për dhënien me koncesion, të formës "BOT" (ndërtim, operim dhe transferim), të hidrocentralit "STAVEC 1", është Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.
2. Miratimin e bonusit prej 3 për qind të pikëve, për rezultatin teknik dhe financiar, në procedurën konkurruese përzgjedhëse (propozim i pakërkuar), që i jepet shoqërisë "Koka" sh.p.k.
3. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës në procedurën konkurruese për dhënien me koncesion të hidrocentralit "STAVEC 1", të kërkojë shprehje interesi dhe të pranojë oferta, për të gjithë pjesën e lirë të skemës, ku përfshihet ndërtimi i këtij hidrocentrali.
4. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1357, datë 10.10.2008

PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, PËR DHËNIEN ME KONCESION TË HIDROCENTRALIT "DOMAJ", DHE MIRATIMIN E BONUSIT, NË PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE KONKURRUESE, QË I JEPET SHOQËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 3, e 23, pika 3, shkronja "b", të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 "Për koncesionet", me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autoriteti kontraktues për kryerjen e procedurave ligjore, për dhënien me koncesion, të formës "BOT" (ndërtim, operim dhe transferim), të hidrocentralit "DOMAJ", është Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.
2. Miratimin e bonusit prej 3 për qind të pikëve, për rezultatin teknik dhe financiar, në procedurën konkurruese përzgjedhëse (propozim i pakërkuar), që i jepet shoqërisë "THAÇI" sh.p.k.
3. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës në procedurën konkurruese për dhënien me koncesion të hidrocentralit "DOMAJ", të kërkojë shprehje interesi dhe të pranojë oferta, për të gjithë pjesën e lirë të skemës, ku përfshihet ndërtimi i këtij hidrocentrali.

4. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1358, datë 10.10.2008

PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, PËR DHËNIEN ME KONCESION TË HIDROCENTRALIT "MOLLAJ", DHE MIRATIMIN E BONUSIT, NË PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE KONKURRUESE, QË I JEPET SHOQËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 3, e 23, pika 3, shkronja "b", të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 "Për koncesionet", me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autoriteti kontraktues për kryerjen e procedurave ligjore, për dhënien me koncesion, të formës "BOT" (ndërtim, operim dhe transferim), të hidrocentralit "MOLLAJ", është Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.
2. Miratimin e bonusit prej 3 për qind të pikëve, për rezultatin teknik dhe financiar, në procedurën konkurruese përzgjedhëse (propozim i pakërkuar), që i jepet shoqërisë "Bilisht Kompani" sh.p.k.
3. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës në procedurën konkurruese për dhënien me koncesion të hidrocentralit "MOLLAJ", të kërkojë shprehje interesi dhe të pranojë oferta, për të gjithë pjesën e lirë të skemës, ku përfshihet ndërtimi i këtij hidrocentrali.

4. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1360, datë 10.10.2008

PËR LICENCIMIN E INSTITUCIONIT PRIVAT TË ARSIMIT TË LARTË, "SHKOLLA E LARTË "ILLYRIA""

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4, pika 2, 43, 44 e 45 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Licencimin e institucionit privat të arsimit të lartë "Shkolla e lartë "ILLYRIA"", e cila do ta ushtrojë veprimtarinë në qytetin e Tiranës.
2. Institucioni privat i arsimit të lartë "Shkolla e lartë "Illyria"" do të organizohet në dy fakultete:
a) Fakulteti i Drejtësisë, me programin e studimit, në formën e studimeve me kohë të plotë, "Drejtësi" (4 vite akademike).

b) Fakulteti i Shkencave Politike, me programet e studimit, në formën e studimeve me kohë të plotë, "Shkenca politike" (3 vite akademike).

3. Institucioni privat i arsimit të lartë "Shkolla e lartë "Illyria"" do të ofrojë programet e studimeve të ciklit të parë, të cilat do të zgjasin, përkatësisht, 4 e 3 vite, dhe në mbarim të tyre do të lëshohet diplomë e nivelit të parë (DNP), në fushën e arsimimit të kryer.

4. Ngarkohet institucioni privat i arsimit të lartë "Shkolla e lartë "Illyria"" që, për çdo program studimi, të sigurojë, nëpërmjet marrëdhënieve kontraktuale, zhvillimin e disa prej disiplinave kryesore formuese të specialitetit, pas vitit të parë, nga një personel akademik i huaj, me kualifikimin e nevojshëm.

5. Institucioni privat i arsimit të lartë "Shkolla e lartë "Illyria"" do ta fillojë veprimtarinë mësimore për programet e studimit, të përcaktuara në pikën 2 të këtij vendimi, pasi të ketë marrë, jo më vonë se tri javë para fillimit të vitit akademik, lejen përkatëse nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës.

Ministri e lëshon lejen pasi vlerëson se institucioni privat i arsimit të lartë ka përmbushur angazhimet e deklaruara, në përputhje me udhëzimin e tij, për këtë qëllim.

6. Ndryshimet në vendndodhje, plane, forma studimi dhe programe, si dhe në elemente të tjera, të miratuara, bëhen pas miratimit nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

7. Institucioni privat i arsimit të lartë "Shkolla e lartë "Illyria"" duhet t'i nënshtrohet procesit të akreditimit institucional dhe të programeve të studimit, brenda afateve të përcaktuara në ligjin në fuqi.

8. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucion dhe për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

UDHËZIM
Nr.830, datë 14.4.2008

PËR ZBATIMIN E STANDARDEVE TË SHËRBIMEVE TË PËRKUJDESIT SHOQËROR, PËR FËMIJËT NË INSTITUCIONET REZIDENCIALE PUBLIKE DHE JOPUBLIKE

Mbështetur në pikën 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në ligjin nr.9355, datë 10.3.2005 "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", të ndryshuar, dhe në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.659, datë 17.10.2005 "Për standardet e shërbimeve të përkujdesit shoqëror, për fëmijët në institucionet rezidenciale",

UDHËZOJ:

Institucionet rezidenciale publike dhe jopublike, të përkujdesit shoqëror për fëmijë, funksionojnë në bazë të standardeve dhe procedurave të mëposhtme:

I. DEKLARATA E QËLLIMIT TË INSTITUCIONIT

1. Çdo institucion rezidencial i kujdesit për fëmijë harton një deklaratë qëllimi, e cila parashtron qartë filozofinë e përkujdesit, synimet dhe objektivat e tij.

2. Institucionet rezidenciale të përkujdesit shoqëror për fëmijë duhet të afishojnë deklaratën e qëllimit, e cila të konsiderohet si një dokument që synon:

a) të ndihmojë personat përgjegjës që sistemojnë fëmijët të marrin vendime në lidhje me këtë proces;

b) të informojë stafin, fëmijët, familjet/të afërmit e tyre dhe persona të tjerë të interesuar për politikën dhe mënyrën e ofrimit të shërbimit nga institucioni.

3. Deklarata e qëllimit formulohet edhe në një gjuhë lehtësisht të kuptueshme nga fëmijët në formën e një "udhëzuesi për fëmijët", i cili i vihet në dispozicion fëmijës menjëherë, pasi ai vendoset në institucion.

4. "Udhëzuesi për fëmijët" përshkruan qartë mënyrën e organizimit të institucionit, shërbimet që ofrohen, rregullat dhe procedurat e jetesës në institucion, informacion për stafin dhe fëmijët,

detyrimet dhe të drejtat e tyre etj.

5. Deklarata e qëllimit nënshkruhet nga drejtuesi i shërbimit dhe nga struktura përgjegjëse për administrimin e institucionit rezidencial (Shërbimi Social Shtetëror ose njësia e qeverisjes vendore).

6. "Deklarata e qëllimit" vendoset në një vend të dukshëm dhe është e disponueshme për të gjithë anëtarët e stafit, fëmijët, prindërit, të afërmit etj.

7. Fëmijët që vijnë nga një situatë emergjente, sistemohen në ato institucione rezidenciale, të cilat në deklaratën e tyre të qëllimit kanë të parashikuara rregulla dhe kapacitete për pranimet emergjente.

8. Deklarata e qëllimit të institucionit rishikohet sa herë që institucioni i përkujdesit shoqëror shton aktivitetin e tij, por që asnjëherë nuk del jashtë objektit të licencimit.

II. PLANI I PËRKUJDESIT

9. Për çdo fëmijë hartohet plani i përkujdesit, i cili përfshin të gjitha objektivat dhe masat që duhet të merren për plotësimin e nevojave të fëmijëve, duke marrë në konsideratë moshën, gjininë, situatën sociale të origjinës, bindjet fetare, racën etj. Plani i përkujdesit përfshin një vlerësim të fëmijës dhe të familjes/institucionit ku ka jetuar më parë fëmija.

10. Nevojat e fëmijës vlerësohen nga një ekip multidisiplinar, ku profesionistët dhe ofruesit e tjerë të shërbimeve, punojnë së bashku për të vlerësuar nevojat në plane të ndryshme, me qëllim maksimizimin e mundësive të fëmijës për të arritur potencialin e tij.

11. Sistemi i planifikimit të kujdesit përmban: i) formularin për informacionin e domosdoshëm; ii) raportin për vlerësimin e nevojave; iii) planin e kujdesit; iv) rishikimin e planit të përkujdesit.

i) Formulari për informacionin e domosdoshëm

12. Formulari për informacionin e domosdoshëm, për fëmijën e vendosur në institucionin rezidencial, ofron të dhëna bazë për stafin. Ky informacion grumbullohet dhe përpunohet brenda javës së parë pas vendosjes së fëmijës në institucion. Punonjësi social i institucionit është përgjegjës për grumbullimin e informacionit dhe plotësimin e formularit.

ii) Vlerësimi i nevojave

13. Vlerësimi i nevojave duhet të nxjerrë në pah nevojat individuale të fëmijës për zhvillim dhe duhet të përfundojë e brenda muajit, nga çasti i vendosjes së fëmijës në institucion.

14. Vlerësimi i nevojave përfshin fushat: nevojat sociale, shëndetësore, nevojat për arsimim, realizimin dhe mbajtjen e lidhjeve me familjen, miqtë dhe persona të tjerë të rëndësishëm, si dhe fusha të tjera sipas grupmoshës dhe nevojave individuale të fëmijës.

15. Kujdestari monitoron procesin e vlerësimit të fëmijës gjatë kohës së qëndrimit në institucionin e përkujdesit rezidencial.

16. Vlerësimi i nevojave të fëmijës realizohet në përputhje me formularët e ndarë sipas grupmoshave (anekset 2.2.1; 2.2.2; 2.2.3; 2.2.4; 2.2.5).

iii) Plani i kujdesit

17. Plani i kujdesit hartohet pas vlerësimit të nevojave dhe përfshin masat afatgjata për të ardhmen e fëmijës. Plani i kujdesit duhet të plotësohet brenda dy muajve pas vendosjes së fëmijës në institucion.

18. Në çdo institucion caktohet një ekip me staf të specializuar, që kanë përgjegjësinë për hartimin e planit të kujdesit për çdo fëmijë.

19. Plani i kujdesit është i ndarë në 2 pjesë: i) pjesa e parë përcakton planin e përgjithshëm të institucionit për fëmijët (shih aneksin 3); dhe ii) pjesa e dytë detajohet sipas nevojave të fëmijës që duhet të plotësohen gjatë periudhës që ai është në institucion.

20. Fëmija përfshihet në procesin e planifikimit të kujdesit në përputhje me grupmoshën, kapacitetin dhe aftësitë individuale të tij/saj.

21. Plani i kujdesit, përmban të dhëna për përfshirjen e fëmijëve në proces dhe mendimin e tyre për masat e parashikuara. Plani i kujdesit është i disponueshëm për çdo fëmijë.

22. Kujdestari i caktuar për fëmijën është përgjegjës për procesin dhe duhet të jetë në gjendje të flasë me kompetencë dhe saktësi për fëmijën, duke treguar se e kupton situatën e fëmijës dhe të familjes.

23. Plani i kujdesit përfshin: planin personal për arsimimin në fëmijërinë e hershme (PPAFH),

planin personal për arsimimin (PPA) dhe planin e nevojave shëndetësore (PNSH).

iv) Rishikimi i planit të kujdesit

24. Plani i kujdesit rishikohet një herë në gjashtë muaj. Në planin e rishikuar të kujdesit vendosen të dhëna nëse fëmija dhe familja/të afërmit e tij janë njoftuar të marrin pjesë në mbledhjen e rishikimit.

25. Gjatë hartimit të planit të kujdesit dhe rishikimit të tij, duhet të merren të dhëna e informacion nga institucione të tjera të rëndësishme për fëmijën (kopshti, shkolla, shërbimet shëndetësore, OJF-të etj.). Këto informacione pasqyrohen në planin e kujdesit të fëmijës dhe në formularin për rishikimin e tij.

III. PLANI PËRGATITOR PËR LARGIMIN E FËMIJËS NGA KUJDESI REZIDENCIAL

26. Fëmijët e vendosur në institucione të kujdesit rezidencial duhet të kenë një plan të plotë mbështetjeje për të përgatitur largimin nga kujdesi rezidencial, për jetesë të pavarur, drejt birësimit, familjes biologjike apo kujdestare, institucionit rezidencial sipas grupmoshës apo formave të tjera të përkujdesit.

27. Plani i kujdesit me rastin e largimit (plani i birësimit, plani për të jetuar i pavarur dhe plani i kalimit) duhet të përputhet me planin e kujdesit për fëmijën.

28. Plani i kujdesit me rastin e largimit duhet të marrë parasysh çdo aftësi të kufizuar ose çështje të veçantë shëndetësore që mund të ketë fëmija.

29. Fëmija, kujdestari ligjor dhe prindi biologjik marrin pjesë në çdo fazë dhe aspekt të hartimit dhe zbatimit të planit të kujdesit me rastin e largimit.

30. Nëse rezultati i planit të kujdesit është birësimi, atëherë për fëmijën përgatitet plani i birësimit (aneksi 4.1).

31. Në rastet kur plani i kujdesit është shkolla me konvikt, jetesë e pavarur, vendosje në familjen biologjike, vendosje në kujdestari, atëherë përgatitet plani i rrugës për të ardhmen (aneks 4.2).

32. Fëmija merr pjesë në përgatitjen e planit të rrugës për të ardhmen duke plotësuar një format të veçantë, i cili pasqyrohet në aneksin 4.3.

IV. OFRIMI PHE PËRGATITJA E VAKTEVE

33. Fëmijët duhet të marrin pjesë në hartimin e menusë, blerjen dhe përgatitjen e ushqimit, përgatitjen e tavolinës për ngrënie me qëllim përfitimin e shprehive për jetën e tyre të pavarur.

34. Menyja duhet të jetë e ushqyeshme, e shëndetshme, e larmishme dhe e mjaftueshme në sasi. Gjatë hartimit të menysë të mbahen parasysh nevojat për ushqim në përputhje me grupmoshën dhe nevojat e veçanta të fëmijëve. Stafi duhet të ketë njohuri për nevojat ushqimore, teknikat e ushqyerjes së fëmijëve dhe çrregullimet e të ngrënit te fëmijët e vegjël dhe adoleshentët.

35. Vaktet e ushqimit ofrohen në orë të caktuara në përputhje me regjimin e nevojshëm ditor të fëmijëve. Për fëmijët që e kalojnë një vakt buke, ushqimi duhet të jetë menjëherë i disponueshëm. Ndërmjet vakteve të ngrënies, fëmijëve u ofrohen ushqime të lehta, si lëngje frutash, fruta etj., të cilat mund të konsumohen edhe në ambientet e tjera të shtëpisë.

36. Mjediset e ngrënies së vakteve duhet të jenë të mobiluara me karrige e tavolina të përshtatshme për të gjithë fëmijët, në mënyrë që fëmijët të ndjehen sa më të lirshëm, të qetë, komunikues dhe të relaksuar.

V. PLOTËSIMI I NEVOJAVE PËR VESHJE DHE SENDE PERSONALE

37. Fëmijët e vendosur në kujdes rezidencial nxiten të zgjedhin vetë veshjet dhe sendet e nevojshme personale. Çdo institucion, brenda buxhetit të parashikuar, duhet të diskutojë dhe të bisedojë me fëmijët për nevojat e tyre për veshje, si dhe sende të nevojshme personale.

38. Të gjithë fëmijët duhet të kenë veshje të pastra, të rregullta që përmbushin nevojat individuale të tyre. Ata mbështeten, inkurajohen dhe udhëzohen nga kujdestari dhe personeli i institucionit në zgjedhjen dhe blerjen e veshjeve, përdorimin e produkteve kozmetike apo sanitare, sendeve të tyre personale, duke respektuar moshën, gjininë, etninë, fenë etj.

39. Për fëmijët me shqetësime alergjike apo shëndetësore sigurohen sendet e nevojshme dhe iu ofrohen shërbime të veçanta në përputhje me nevojat e tyre. Në raportin e vlerësimit të nevojave dhe në planin e kujdesit të këtyre fëmijëve vendosen shënimet përkatëse për këto situata.

40. Fëmijët duhet të inkurajohen dhe mbështeten për të njohur vlerën e të hollave, duke i mësuar të menaxhojnë dhe të përdorin shumën e të hollave që u jepet për shpenzime personale. Diskutimet dhe bisedat me fëmijët për menaxhimin e të hollave dhe vlerën e tyre duhet të jenë të

evidentuara në materialet e punës me fëmijët.

VI. PLANI I NEVOJAVE SHËNDETËSORE

41. Për çdo fëmijë të vendosur në institucion rezidencial, bazuar në vlerësimin e nevojave fizike, emocionale dhe mendore të fëmijës, duhet të përgatitet plani i nevojave shëndetësore.

42. Shtëpia mban dokumentacion me shkrim për të gjitha mjekimet, trajtimet dhe ndihmën e parë që kanë marrë fëmijët gjatë qëndrimit në institucion. Kur në qendër ofrohen shërbime në lidhje me shëndetin e fëmijëve, këto duhen bërë vetëm me autorizimin me shkrim të mjekut përgjegjës që ndjek qendrën.

43. Fëmijëve u lejohen që ta zgjedhin gjininë e mjekut ose dentistit, në ato raste kur kjo është e mundur.

44. Fëmijëve me nevoja të veçanta shëndetësore ose me aftësi të kufizuara të lehta duhet t'u sigurohet mbështetja e duhur që të përballen me ndryshimin e tyre në një mënyrë sa më pozitive të mundshme. Nga fëmijët dhe stafi të krijohet një mjedis pozitiv nxitës, mbështetës, pa fyerje e ofendime.

45. Kujdestari i fëmijës dhe fëmija krijojnë lidhje me mjekun e autorizuar, nga i cili marrin këshilla dhe udhëzime për nevoja të mundshme specifike shëndetësore.

46. Plani i nevojave shëndetësore është pjesë e planit të kujdesit dhe si seksion i veçantë i tij, duhet të analizohet dy herë në vit (shih aneksin 3, pika 9).

VII. PLANI I NEVOJAVE PËR ARSIMIM

47. Plani i kujdesit përfshin: planin personal për arsimimin në fëmijërinë e hershme, (PPAFH), planin personal të arsimimit (PPA).

48. Për fëmijët 0-6 vjeç, PPAFH përfshin objektivat e të mësuarit në fëmijërinë e hershme si zhvillimi personal, emocional, shoqëror, komunikimi, gjuha, shkrimi, zhvillimi krijues etj. Në rastet kur fëmija ndjek arsimin parashkollor në çerdhe/kopsht, PPAFH përfshin edhe mbarëvajtjen e fëmijës në këto institucione (shih aneksin 5).

49. Plani personal për arsimim për fëmijët parashtron me hollësi të gjitha aspektet e nevojave të fëmijës për arsimim.

50. Çdo fëmije, në përputhje me grupmoshën dhe kapacitetin, duhet t'i jepet plotësisht mundësia që t'i përdorë strukturat arsimore brenda ose jashtë institucionit. PPA përfshin në detaje historinë arsimore, ecurinë dhe arritjet në ndjekjen e arsimit.

51. Fëmijët me aftësi të kufizuara të lehta kanë të drejtë të ndjekin programe të specializuara arsimi, brenda dhe jashtë institucionit.

52. PPA duhet të përcaktojë dhe t'i përgjigjet çdo problemi në lidhje me ecurinë shkollore të fëmijës, duke i kushtuar vëmendje të veçantë aspekteve të mëposhtme:

a) Fëmijëve duhet t'u krijohen kushte për të studiuar dhe për të bërë detyrat e shtëpisë pas kthimit nga shkolla. Të gjithë fëmijët duhet të marrin mbështetje, lavdërime dhe inkurajim nga stafi i institucionit për ndjekjen e shkollës, rezultatet pozitive, studimin pas shkollës etj. Për këtë arsye nga kujdestari/punonjësi social plotësohet plani personal i arsimimit, PPA (shih aneksin 6).

b) Në kuadrin e përgatitjeve për rishikimin gjashtëmujor të planit të kujdesit, bazuar në PPA, plotësohet rishikimi i planit personal të arsimimit (RPPA) (shih aneks 6.1).

53. Drejtuesi i institucionit duhet të sigurojë që kujdestari/punonjësi social i fëmijës të marrë pjesë gjithmonë në mbledhjet e prindërve, në kopsht/shkollë.

VIII. KOHA E LIRË DHE VEPRIMTARITË ARGËTUESE

54. Argëtimi i fëmijëve në kohën e lirë, organizimi i veprimtarive të ndryshme social-kulturore kontribuojnë në zhvillimin e përgjithshëm të fëmijës. Interesat dhe talentet e veçanta të fëmijëve të veçantë duhet të trajtohen brenda planit të kujdesit.

55. Në institucionet e përkujdesit të fëmijëve është e rëndësishme që të krijohet dhe të ruhet një kulturë pozitive në lidhje me zbavitjet dhe veprimtaritë në kohën e lirë.

56. Stafi i qendrës dhe fëmijët duhet angazhohen bashkërisht në procesin e diskutimit, konsultimit dhe vendimmarrjes në lidhje me planifikimin e kohës së lirë, veprimtaritë, festat e veçanta, pushimet dhe shëtitjet, me qëllim arritjen e një ekuilibri mes kohës "së kontrolluar" dhe kohës "së lirë", gjatë një dite të zakonshme në institucion. Fëmijët duhet të kenë mundësinë të zgjedhin libra, gazeta, revista kulturore apo humoristike.

57. Fëmijët inkurajohen të përfshihen në veprimtaritë komunitare në zonën ku ndodhet institucioni, mbështeten në krijimin e miqësive jashtë dhe brenda institucionit nëpërmjet mikpritjes së

miqve të përshtatshëm për vizita në ambientin ku fëmija jeton (shih aneksin 3, pikat 5, 6 dhe 8).

IX. ANKIMIMI

58. Fëmijët që vendosen në institucionet e përkujdesit rezidencial, familjet apo të afërmit e tyre, mund të ankohen për çështje për të cilat ata nuk janë të kënaqur dhe që mendojnë se janë të padrejta, të pasigurta dhe të pavend.

59. Procedurat e ankimimit dhe afatet kohore janë të disponueshme dhe duhet të jenë të ekspozuara në tabelat e njoftimeve të institucionit.

60. Kujdestari i fëmijës është i përfshirë në të gjitha fazat e procesit të ankimimit. Stafi i institucionit duhet të ketë informacion "pse" dhe "si" duhen zbatuar procedurat e ankimimit dhe fëmijët gjithashtu mund të ndihmohen që ta kuptojnë qëllimin dhe rëndësinë e ankimimit. Nuk ka përcaktime të prera për aneksin (aneksi 7).

61. Të gjithë vizitorët, përfshirë prindërit e fëmijëve, janë të lirë për të ndjekur procedurat e ankimimit.

62. Institucioni i përkujdesit ndjek një procedurë të veçantë për trajtimin e fyerjeve, e cila ka të bëjë me çdo situatë ose kontekst në të cilin fëmija përjeton fyerje, sharje dhe veprime të tjera që cenojnë personalitetin dhe dinjitetin e tij. Fyerjet apo sharjet përfshijnë ngacmimin që bëhet nga çdokush përfshi stafin, për shkak të racës, etnisë, fesë, kulturës, gjinisë, aftësisë së kufizuar dhe orientimit seksual të fëmijëve.

63. Incidentet dhe sjelljet fyese dhe sharëse nuk duhen toleruar asnjëherë, ngjarja duhet trajtuar me kujdes dhe fëmijët që fyhen dhe shahen duhen mbështetur nga stafi, i cili është i ndërgjegjësuar për këto sjellje dhe ka aftësi për trajtimin e tyre dhe gjetjen e zgjidhjeve.

64. Fëmijët që fyejnë dhe shajnë (verbalisht ose me sjellje) duhet të marrin mesazhin e qartë se nuk është personi, por është sjellja ajo që është e papranueshme. Këta fëmijë duhet të mbështeten dhe të udhëzohen që ta ndryshojnë sjelljen e tyre fyese dhe sharëse.

X. SIGURIA DHE MBROJTJA E FËMIJËVE

65. Mirëqenia dhe siguria e fëmijës janë drejtimet kryesore që garantohen gjatë gjithë periudhës që është i vendosur në institucion, kjo edhe për faktin se fëmija mund të ketë përjetuar një formë të caktuar keqtrajtimi në ambientin ku ka jetuar më parë.

66. Mbrojtja e fëmijës mbështetet në evidentimin dhe plotësimin e nevojave të veçanta, bazuar në vlerësimin e gjithë jetës së fëmijës, aspekteve emocionale, fizike, arsimore, sociale, gjinore, fetare, etnike, kulturore dhe gjuhësore.

67. Çdo fëmijë, i cili ka qenë i përfshirë në keqtrajtim, si viktimë e keqtrajtimit apo si keqtrajtues i të tjerëve, duhet të marrë mbështetje, këshilla, modele të reja sjelljeje, që të ndihmohet të përballet me këto çështje.

68. Çdo fëmijë të mbështetet dhe ndihmohet që të përfshihet në aspekte të jetesës në grup të institucionit, duke zvogëluar vetminë dhe izolimin. Vëmendje duhet t'u kushtohet fëmijëve të cilët nuk mund të përshtaten menjëherë në mjedisin dhe jetën e përbashkët.

69. Çdo fëmijë në përputhje me moshën duhet të mbështetet për të kuptuar dhe menaxhuar disa rreziqe në përputhje me moshën, si duhanpirja, marrëdhëniet ndërpersonale dhe seksuale, qëndrimi në mbrëmje vonë jashtë institucionit, përdorimi i të ardhurave personale etj.

70. Institucioni, në përputhje me deklaratën e qëllimit, duhet të ketë parashikuar masa paraprake të efektshme për të siguruar institucionin nga hyrja e personave të paautorizuar. Informacioni për këto masa duhet t'u transmetohen fëmijëve, familjarëve apo të afërmve të tyre.

XI. VENDNDODHJA, MODELI DHE MADHËSIA E INSTITUCIONIT

71. Në përputhje me deklaratën e qëllimit, institucioni rezidencial për fëmijët duhet të jetë i zbukuruar, i mobiluar dhe i pajisur me qëllim krijimin e një mjedisi të ngrohtë, të këndshëm, familjar për fëmijët që jetojnë aty, duke i kushtuar rëndësi imazhit pozitiv dhe larmishmërisë që lidhet me gjininë, etninë, kulturën, aftësinë e kufizuar dhe seksualitetin.

72. Institucioni duhet të ofrojë një mjedis mbështetës, për të përmbushur nevojat e çdo fëmije për kujdes, mirëqenie, argëtim dhe intimitet.

73. Institucioni duhet të ketë një dhomë të veçantë për mjekimet ku nuk hyjnë fëmijët. Kjo dhomë është e mbyllur dhe çelësi i saj, mbahet në një vend të sigurt, që nuk arrihet nga fëmijët. Dhoma e caktuar për mjekimet duhet të jetë e pajisur me një listë për kontrollin e barnave dhe mjeteve. Drejtori cakton një punonjës (infermier) për mbajtjen e inventarit.

74. Pjesa e brendshme dhe e jashtme e dhomave duhet të mirëmbahet apo dhe të zbukurohet

sipas një programi për mirëmbajtjen dhe riparimin duke bërë dallime mes hapësirës private të fëmijëve dhe hapësirës kolektive.

75. Fëmijët inkurajohen dhe mbështeten që të përfshihen në vendimet që merren në lidhje me zbukurimin dhe mobilimin e institucionit, dhomës së tyre të gjumit, vendosjen e posterave, fotografive etj.

76. Ambientet që përdoren për lexim, studim duhet të jenë të bollshme, me tavolina dhe vende të mjaftueshme për t'u ulur, me ndriçimin e duhur dhe temperaturë të përshtatshme sipas stinës. Institucioni duhet të ofrojë hapësirë dhe komoditet të mjaftueshëm që fëmijët të takohen privatisht me vizitorët.

77. Dhomat ku fle stafi, duhet të jenë pranë dhomave të gjumit të fëmijëve, me qëllim që stafi të jetë në gjendje t'u përgjigjet nevojave që mund të kenë ata gjatë natës. Stafi asnjëherë nuk duhet të flerë në të njëjtën dhomë me fëmijët.

78. Institucioni duhet të sigurojë minimalisht një banjë e ose dush për çdo gjashtë fëmijë, në afërsi të të cilave duhet të ketë struktura për të larë dhe tharë duart.

79. Vendndodhja dhe modeli i banjës dhe tualetit duhet të marrë në konsideratë nevojën për intimitet, dinjitet dhe siguri. Banja dhe tualeti duhet të jenë menjëherë të arritshme si nga hapësirat e fjetjes, ashtu edhe nga hapësirat e argëtimit të institucionit. Stafi duhet të përdorë tualet dhe banjë të veçantë nga ato të fëmijëve. Uji i ftohtë dhe i nxehtë duhet të jenë të disponueshëm 24 orë.

XII. STRUKTURA E PERSONELIT

80. Në deklaratën e qëllimit tregohet dhe struktura e stafit, si përcaktohen përgjegjësitë, procesi i përzgjedhjes dhe rekrutimit te tij. Kjo strukturë duhet të jetë e mjaftueshme që në çdo kohë të përmbushen nevojat e veçanta të fëmijëve rezidentë.

Marrëdhëniet e punës për stafin e institucionit të përkujdesit rregullohen mbështetur në dispozitat e Kodit të Punës.

Një përmbledhje e gjithë dokumentacionit të nevojshëm që duhet të plotësohet, procedurat dhe afatet kohore, gjenden në materialin bashkëlidhur këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËS, ÇËSHTJEVE SOCIALE
DHE SHANSEVE TË BARABARTA
Koço Barka

VENDIM
Nr.72, datë 7.10.2008

PËR DISA NDRYSHIME NË RREGULLOREN "PËR ADMINISTRIMIN E RREZIKUT NGA EKSPOZIMET E MËDHA TË BANKAVE"

Në bazë dhe për zbatim të nenit 1, pika 4, shkronja "b", të nenit 12, shkronja "a", të nenit 43, shkronja "c", të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 57, pika 2, nenit 58, pika 1, shkronja "b", nenit 62, pika 2 , shkronja "b", dhe nenit 64 të ligjit nr.9662, datë 18.12.2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë

VENDOSI:

1. Në rregulloren "Për administrimin e rrezikut nga ekspozimet e mëdha të bankave", miratuar me vendimin nr. 31, datë 30.4.2008 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Shkronja "e" e nenit 5, paragrafi (iii) dhe paragrafi (v) i shkronjës "b" të nenit 8, shfuqizohen.

2. Në nenin 7, shtohet pika 6 me përmbajtjen e mëposhtme:

"Ekspozimi i bankës ndaj shoqërisë mëmë, filialit të bankës apo një ose më shumë filialeve të

shoqërisë mëmë, nuk mund të tejkalojë 10 (dhjetë) për qind të kapitalit rregullator".

2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

3. Ngarkohet Departamenti i Statistikave për reflektimin e të gjitha ndryshimeve të nevojshme në formularët e raportimit (SRU), që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi.

4. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integrimit Europian dhe Komunikimit për publikimin e këtij vendimi në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ardian Fullani

VENDIM
Nr.114, datë 1.10.2008

PËR NDRYSHIMIN E KUSHTEVE TË LICENCËS PËR USHTRIMIN E AKTIVITETIT TË SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA OSSH SHA

Në mbështetje të neneve 9, 15 dhe 19, pika 2, të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, pikës 7 të modelit të tregut të energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.338, datë 19.3.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 1.10.2008, mbasi shqyrtoi propozimin për ndryshimin e kushteve të licencës për ushtrimin e aktivitetit të shpërndarjes së energjisë elektrike nga OSSH sh.a.,

dhe konstatoi se:

- OSSH sh.a. është licencuar nga ERE për aktivitetin e shpërndarjes së energjisë elektrike me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.8, datë 25.1.2008 "Për dhënien e licencës për aktivitetin e shpërndarjes së energjisë elektrike shoqërisë OSSH sh.a.".
- Modeli i tregut të energjisë elektrike i miratuar nga Këshilli i Ministrave parashikon në pikën 7, rolin e ERE-s, e cila duhet të procedojë me rishikimin e akteve nënligjore që lidhen me funksionimin e tregut të energjisë elektrike.
- Me vendimin nr.108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve miratoi rregulloren për procedurat e licencimit, në të cilën afati i vlefshmërisë së licencës për aktivitetin e shpërndarjes është në harmoni me afatin e vlefshmërisë së licencës të aktivitetit të shpërndarjes të përcaktuar në modelin e licencës për këtë aktivitet.
- Me vendimin nr.69, datë 24.6.2008, Bordi i Komisionerëve ka miratuar licencën për aktivitetin e shpërndarjes së energjisë elektrike.
- Ligji për sektorin e energjisë elektrike i atribuon ERE-s të drejtën që me iniciativën e vet të ndryshojë kushtet e një licence kur ka ndryshim në kuadrin ligjor,

për gjithë sa më sipër dhe me qëllim që aktet nënligjore të miratuara nga ERE në funksion të implementimit të modelit të tregut të energjisë elektrike, të reflektohen edhe në ushtrimin e aktivitetit nga subjektet e licencuara, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Duke filluar nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, OSSH sh.a. është subjekt i kushteve të licencës së miratuar nga ERE me vendimin nr.69, datë 24.6.2008 "Për miratimin e licencës për aktivitetin e shpërndarjes së energjisë elektrike".

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut ta njoftojë shoqërinë OSSH sh.a. për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

VENDIM
Nr.115, datë 1.10.2008

PËR MIRATIMIN E LICENCËS PËR VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 9, 15, pika 1, të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 1.10.2008, pasi shqyrtoi draftin e licencës për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit,

VENDOSI:

1. Të miratojë licencën për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike (licenca bashkëlidhur këtij vendimi).

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

VENDIM
Nr.116, datë 1.10.2008

MBI VAZHDIMIN E KRYERJES SË AKTIVITETIT TË IMPORTIT DHE EKSPORTIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA TË LICENCUARIT NË KËTO AKTIVITETE PËR PERIUDHËN E MBETUR TË VLEFSHMËRISË SË LICENCËS SI AKTIVITET I TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 8, pika 2, germa "a", 9 dhe 13, pika 8, të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, neneve 1 pika 1, dhe 8 pika 1 të licencës për aktivitetin e importit të energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.55, datë 12.10.2005, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 1.10.2008, mbasi shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për trajtimin e të licencuarve deri më tani nga ERE për aktivitetin e importit dhe eksportit të energjisë elektrike si të licencuar për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike,

dhe konstatoi se:

- Me miratimin e ligjit nr.9913, datë 5.5.2008 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike"", është shfuqizuar licencimi i aktiviteteve për importin dhe eksportin e energjisë elektrike dhe vendoset si aktivitet i licencuar tregtimi i energjisë elektrike.

- Në pikën 2 të modelit të tregut të energjisë elektrike të miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.338, datë 19.3.2008, përcaktohen si pjesëtare të tregut, tregtuesit të cilët në kuptim të modelit të tregut kryejnë praktikisht aktivitetin e importit dhe eksportit të energjisë elektrike por tani me nënemërtim tregtar të energjisë elektrike.

- Gjithashtu modeli i tregut të energjisë elektrike, në pikën 7 përcakton edhe autoritetin e

ERE-s për kryerjen e rishikimeve të nevojshme në aktet nënligjore si pjesë e rëndësishme e funksionimit të tregut të energjisë elektrike në Shqipëri.

- Licenca për importin e energjisë elektrike e miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.55, datë 12.10.2005 parashikon se ERE mund të amendojë kushtet e licencës në rast se ato nuk përputhen me legjislacionin në fuqi,

për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Duke filluar nga hyrja në fuqi e këtij vendimi të gjithë personat e licencuar nga ERE për aktivitetin e importit dhe eksportit të energjisë elektrike do të vazhdojnë të kryejnë aktivitetin në sektorin e energjisë elektrike për periudhën e mbetur të vlefshmërisë së licencës, si të licencuar në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike duke qenë subjekt i kushteve të licencës për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut t'i njoftojë personat e licencuar nga ERE në aktivitetin e importit dhe eksportit për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

VENDIM
Nr.119, datë 9.10.2008

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË "UNIVERSI" SHPK NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 9, 13, pika 1, germa "d", të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, neneve 5, 13 dhe 14 të "Rregullores për procedurat e licencimit", të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.121, datë 4.4.2007, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 9.10.2008, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria "Universi" sh.p.k., për t'u licencuar në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike

dhe konstatoi se:

- Fillimi i procedurave për shqyrtimin e aplikimit të "Universi" sh.p.k., ka nisur me marrjen e vendimit nr.85, datë 17.7.2008.

- Rregullorja për procedurat e licencimit e miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 9.9.2008 në nenin 20 parashikon se për të gjitha aplikimet e paraqitura para hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje do të aplikohen rregullat e përcaktuara në rregulloren e procedurave të licencimit të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.21, datë 4.4.2007.

- Aplikimi i shoqërisë për t'u licencuar në aktivitetin e tregtimit është në përputhje me kërkesat e vendosura nga ERE, në përputhje me rregulloren për procedurat e licencimit,

për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë "Universi" sh.p.k. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike për një afat 5-vjeçar.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut ta njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S

Bujar Nepravishta

VENDIM
Nr.120, datë 9.10.2008

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË SHQYRTIMIT TË APLIKIMIT TË SHOQËRISË "UNION EOLICA ALBANIA" SHPK PËR KUALIFIKIMIN E IMPIANTIT PRODHUES (PARKU EOLIK KRYEVIDH, KAVAJË), SI BURIM I RINOVUESHËM ENERGJIE

Në mbështetje të neneve 9 dhe 39 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, të vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.44, datë 24.7.2007 "Për miratimin e rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s", neni 18 dhe të vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.9, datë 21.2.2007 "Për miratimin e rregullave dhe procedurave të certifikimit të prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme", neni 8, Bordi i Komisionerëve, në mbledhjen e tij të datës 9.10.2008, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria "Union Eolica Albania" sh.p.k., për kualifikimin e impiantit prodhues (parku eolik Kryevidh, Kavajë), si burim i rinovueshëm energjie, dhe konstatoi rregullshmërinë e paraqitjes së aplikimit të shoqërisë "Union Eolica Albania" sh.p.k.

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë "Union Eolica Albania" sh.p.k., për kualifikimin e impiantit prodhues (parku eolik Kryevidh, Kavajë), si burim i rinovueshëm energjie.
2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut ta njoftojë aplikuesin lidhur me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

VENDIM
Nr.121, datë 9.10.2008

PËR MOSFILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË "ENPOWER ALBANIA" SHPK PËR KREYRJEN E AKTIVITETIT TË TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 9 dhe 13, pikat 1, germa "d", dhe 8, të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, nenit 10, pika 2, të "Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 9.9.2008 dhe nenit 18, pikat 1 germa "a", dhe 3, të "Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.44, datë 24.7.2007, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 9.10.2008, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria "Enpower Albania" sh.p.k., për t'u licencuar në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike

dhe konstatoi:

1. Mosparaqitjen e plotë të dokumentacionit të kërkuar sipas rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave, nga shoqëria "Enpower Albania" sh.p.k. më datë 24.9.2008 për licencimin për kryerjen e aktivitetit të tregtimit të energjisë elektrike në lidhje me:

- Paraqitjen e strukturës së ndërtimit dhe funksionimit administrativ të shoqërisë. Lista e personelit sipas profilit (në përputhje me aktivitetin për të cilin kërkohet licenca) (neni 9, pika 2, germa "e", nuk është plotësuar. Janë paraqitur vetëm disa CV të personelit të shoqërisë.

- Kërkesa për dokumente që vërtetojnë aftësinë dhe/ose mbështetjen financiare të aplikuesit, ku shprehen qartë vlerat monetare për financimin dhe struktura e financimit (financim i vetë aplikuesit, kredi bankare, donacion, të tjera etj.).

- (Neni 9, pika 3, germa "c" rezulton jo e plotësuar në përputhje me rregulloren, pasi referencat bankare të paraqitura mbajnë datën 20.11.2007 dhe janë lëshuar për t'u paraqitur në aplikimin e shoqërisë për licencë në aktivitetin e ndërtimit dhe prodhimit të energjisë elektrike nga parqet eolike duke qenë në kundërshtim me përcaktimet e "Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave" neni 8, pika 3,

për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të mos fillojë procedurat për licencimin e shoqërisë "Enpower Albania" sh.p.k. për kryerjen e aktivitetit të tregtimit të energjisë elektrike.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut ta njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

VENDIM
Nr.122, datë 10.10.2008

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.110, DATË 16.9.2008 "PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË "ENPOWER ALBANIA" SHPK NË AKTIVITETIN E NDËRTIMIT, INSTALIMIT DHE SHFRYTËZIMIT TË CENTRALEVE ELEKTRIKE ME ERË, SI DHE TË PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA PARQET EOLIKE KARABURUN DHE LLOGARA"

Në mbështetje të neneve 9 dhe 13, pika 1, germa "a", 8, të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, të neneve 121 dhe 128 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) në mbledhjen e tij të datës 10.10.2008, pasi shqyrtoi kërkesën e paraqitur nga shoqëria "Enpower Albania" sh.p.k., për modifikimin e licencës së dhënë nga ERE për ushtrimin e aktivitetit të ndërtimit, instalimit dhe shfrytëzimit të centraleve elektrike me erë, si dhe prodhimin e energjisë elektrike dhe relacionet e përgatitura nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit

konstatoi se:

a) ERE, me vendimin nr.110, datë 16.9.2008, ka licencuar shoqërinë "Enpower Albania" sh.p.k. për ushtrimin e aktivitetit të ndërtimit, instalimit dhe shfrytëzimit të centraleve elektrike me erë, si dhe prodhimin e energjisë elektrike, nga parqet eolike Karaburun dhe Llogara.

b) Ky vendim i ERE-s kushtëzohet me realizimin e disa kushteve nga shoqëria "Enpower Albania" sh.p.k.

c) Shoqëria "Enpower Albania" sh.p.k. në shkresën drejtuar ERE-s më datë 24.9.2008 ka kërkuar:

1. Ndryshimin e afatit për përfundimin e projektit nga 36 muaj në 75 muaj (pika 1 germa "d" e vendimit) pasi dimensionet e projektit dhe proceset procedurale administrative shqiptare kërkojnë më tepër kohë se periudha 36 muaj duke marrë në konsideratë edhe kohën që nevojitet për nxjerrjen e lejeve dhe autorizimeve të nevojshme për ushtrimin e aktivitetit.

2. Nryshimin e germës "e" të pikës 1, duke parashikuar pavlefshmërinë e licencës vetëm në rastin e mungesës së raportimit periodik vjetor mbi zhvillimin e aktiviteteve të kantierit, pasi kushtet

dhe afatet mund të mos përmbushen si pasojë e forcës madhore dhe se vendosja e një kushti të tillë do të zvogëlonte mundësinë e kreditimit të projektit nga institucionet financiare.

3. Modifikimin e emrit Karaburun dhe Llogara me "Lungare, Karaburun dhe Rrëza e Kanalit", pasi kjo është zona ku do të lokalizohet projekti.

4. Me shkresën nr.580/2, prot, datë 10.10.2008, shoqëria dërgoi një kronoprogramë të re, si dhe hartat e kërkuara nga ERE, të cilat paraqesin zonën ku do të shtrihet projekti sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.1146, datë 5.8.2008.

d) Kushti i vendosur nga ERE në pikën 1, germa "d" të vendimit nr.11, datë 16.9.2008 merr në konsideratë grafikun e punimeve të paraqitur nga shoqëria "Enpower Albania" sh.p.k. në muajin dhjetor 2007. ERE konsideroi se periudha nga dhjetor 2007 në shtator 2008 i kishte shërbyer shoqërisë për përfundimin e procesit të marrjes së autorizimeve dhe duke bërë një diferencë për këtë periudhë konkludoi në afatin prej 36 muajsh.

e) Kronoprograma e re parashikon fillimin e aktivitetit për realizimin e projektit në shtator 2008, përfundimin e studimit të fisibilitetit në qershor 2010, përfundimin e të gjithë projektit dhe vënien në punë të parkut në dhjetor 2014.

f) Kushti i vendosur në pikën 1, germa "e" të vendimit, nuk ka të bëjë me mosrealizimin e projektit për shkak të ngjarjeve që mund të ndodhin si pasojë e forcës madhore pasi në tipin e licencës për aktivitetin përkatës (subjekt i të cilit është shoqëria "Enpower Albania" sh.p.k.) në pikën 10.2 përcaktohet: Nëse i licencuari përjeton një ngjarje të forcës madhore gjatë afatit të caktuar për ndërtimin dhe instalimin e centralit elektrik dhe prodhimin e energjisë elektrike do ta njoftojë pa vonesë ERE-n duke kërkuar një zgjatje të këtij afati në përputhje me dispozitat e seksionit 3 të kësaj licence. Kushti i vendosur në vendimin e ERE-s ka për qëllim nxitjen e përgjegjësisë së të licencuarit në respektimin e afateve dhe se ky kusht nuk e pengon shoqërinë të paraqesë kërkesën për shtyrjen e afateve në rastet kur do të jetë e nevojshme duke sjellë argumentet e përshtatshme.

g) Në përcaktimin e vendndodhjes së parqeve Karaburun dhe Llogara, ERE i është referuar vendimit të Këshillit të Ministrave nr.1146, datë 5.8.2008 në të cilin në asnjë rast nuk përmendet lokaliteti Rrëza e Kanalit dhe Lungara.

h) Hartat e dërguara nga shoqëria më datë 10.10.2008, në të cilat paraqitet shtrirja e projektit sipas përcaktimeve të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.1146, datë 5.8.2008, përputhen me hartat e dërguara më parë në ERE për efekt të aplikimit për licencë në aktivitetin e ndërtimit, instalimit dhe prodhimit të energjisë elektrike,

për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Në vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.110, datë 16.9.2009 "Për licencimin e shoqërisë "Enpower Albania" sh.p.k. në aktivitetin e ndërtimit, instalimit dhe shfrytëzimit të centraleve elektrike me erë, si dhe prodhimin e energjisë elektrike nga parqet eolike Karaburun dhe Llogara" bëhen këto ndryshime:

- Në titullin e vendimit, në fund të fjalisë hiqen fjalët: "…Karaburun dhe Llogara…" dhe shtohen fjalët si më poshtë:

"sipas vendndodhjes së përcaktuar në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.1146, datë 5.8.2008 dhe dokumentacionit të paraqitur nga shoqëria pranë ERE-s për aplikim për licencë.".

- Në paragrafin e tretë të pikës 1 të vendimit nr.110, datë 16.9.2008 hiqen fjalët "…Karaburun dhe Llogara…" dhe shtohen fjalët si më poshtë:

"sipas vendndodhjes së përcaktuar në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.1146, datë 5.8.2008 dhe dokumentacionit të paraqitur nga shoqëria pranë ERE-s për aplikim për licencë".

- Pika 1 germa "a", afati për paraqitjen e studimit të fisibilitetit brenda 12 muajve nga data e lëshimit të licencës ndryshon dhe bëhet: - deri më 30 qershor 2010.

- pika 1 germa "d", afati prej 36 muajsh ndryshon dhe bëhet: - deri më 31 dhjetor 2014.

2. Germa "e" e pikës 1 të vendimit nr.110, datë 16.9.2008, nuk ndryshohet.

3. Plotësimi nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut i të dhënave të kërkuara në aneksin A dhe C të licencës të bëhet sipas pikës 1 të këtij vendimi.

4. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut ta njoftojë shoqërinë "Enpower Albania" sh.p.k. për këtë vendim të Bordit të Komisionerëve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

VENDIM
Nr.729, datë 29.9.2008

PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT TELEVIZIV PRIVAT VENDOR "TV ABC"

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, rregullores "Mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë rtv" dhe ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë",

VENDOSI:

1. Të rinovohet licenca për subjektin televiziv vendor privat "Tv abc", për një afat të ri 5-vjeçar në fushën e transmetimeve televizive tokësore analoge, me zonë licencimi bashkinë e Korçës.
2. Kushtet e licencës sipas pikës 1 të këtij vendimi mbeten të pandryshuara.
3. Ky vendim i shtrin efektet që nga data 6.2.2008 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Mesila Doda (Demi)

VENDIM
Nr.735, datë 29.9.2008

PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT RADIOFONIK PRIVAT VENDOR "RADIO CLUB ALSION"

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, rregullores "Mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë rtv" dhe ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë",

VENDOSI:

1. Të rinovohet licenca për subjektin radiofonik vendor privat "Radio Club Alsion", për një afat të ri 3-vjeçar në fushën e transmetimeve radiofonike tokësore analoge.
2. Kushtet e licencës sipas pikës 1 të këtij vendimi mbeten të pandryshuara.
3. Ky vendim i shtrin efektet që nga data 29.5.2008 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Mesila Doda (Demi)

VENDIM
Nr.736, datë 29.9.2008

PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT RADIOFONIK PRIVAT VENDOR "RADIO STAR"

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, rregullores "Mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë rtv" dhe ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 "Kodi i

Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë",

VENDOSI:

1. Të rinovohet licenca për subjektin radiofonik vendor privat "Radio Star", për një afat të ri 3-vjeçar në fushën e transmetimeve radiofonike tokësore analoge, me zonë licencimi qytetin e Fierit.
2. Kushtet e licencës sipas pikës 1 të këtij vendimi mbeten të pandryshuara.
3. Ky vendim i shtrin efektet që nga data 2.5.2008 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Mesila Doda (Demi)

VENDIM
Nr.737, datë 29.9.2008

MBI VLEFSHMËRINË E LICENCËS SË SUBJEKTIT "TV KABLLOR SYNEJ"

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, i përbërë nga:

Mesila Doda (Demi)	Kryetare
Artan Zeneli	Anëtar
Detar Hysi	Anëtar
Alban Karapici	Anëtar
Gent Ibrahimi	Anëtar
Sami Neza	Anëtar

Pasi mori në shqyrtim çështjen me:
Objekt: Mbi vlefshmërinë e licencës së subjektit "Tv kabllor Synej"
Baza ligjore: Neni 7 pika 21, neni 33 pika 5 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, si dhe vendimi nr.708, datë 16.7.2008 "Mbi vlefshmërinë e licencës së subjektit "Tv kabllor Synej",

VËREN SE:

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, me vendimin nr.487,datë 17.7.2006, ka licencuar subjektin fizik z.Gramoz Ismaili për televizionin privat kabllor "Tv kabllor Synej" me nr.licence 046/RTVK, duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv privat kabllor, për një periudhë prej 6 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të licencës.

Me vendimin nr.708, datë 16.7.2008 "Mbi vlefshmërinë e licencës së subjektit "Tv kabllor Synej"", KKRT-ja vendosi të paralajmërojë këtë subjekt për pavlefshmëri të licencës, pasi nuk kishte shlyer pagesën vjetore për licencë për vitin 2007.

Lidhur me këtë vendim, subjekti "Tv kabllor Synej" u njoftua nga KKRT-ja me shkresën nr.642 prot., datë 23.7.2008.

Sipas pikës 2 të vendimit të sipërcituar, ky subjekt kishte të drejtë që brenda 30 ditëve të parashtronte pretendimet e tij lidhur me këtë vendim, por deri tani, KKRT-ja vëren se, edhe pse kanë kaluar më shumë se 30 ditë, subjetkti "Tv kabllor Synej" nuk ka depozituar asnjë pretendim lidhur me vendimin në fjalë.

KKRT-ja konstaton se subjekti "Tv kabllor Synej" nuk ka shlyer pagesën vjetore për licencë për vitin 2007 dhe se në bazë të nenit 33, pika 5, të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, KKRT ka të drejtë të bëjë të pavlefshme licencën "…kur kërkuesi nuk e tërheq licencën ose nuk realizon detyrimet financiare të parashikuara me ligj pas 90 ditëve nga momenti kur merr dijeni zyrtarisht për miratimin e saj".

PËR KËTO ARSYE,

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, në mbështetje të nenit 7 pika 21 dhe nenit 33 pika 5 të ligjit nr.8410,datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë" të ndryshuar, si dhe vendimit nr.708, datë 16.7.2008 "Mbi vlefshmërinë e licencës së subjektit "Tv kabllor Synej",

VENDOSI:

1. T'i heqë licencën subjektit televiziv privat kabllor "Tv Synej".
2. Licenca nr.046/RTVK bëhet e pavlefshme.
3. Subjekti "Tv kabllor Synej" detyrohet të ndërpresë menjëherë transmetimin.
4. Subjekti ka të drejtën e ankimit në gjykatë.
5. Ngarkohet administrata e KKRT-së për zbatimin e këtij vendimi.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Mesila Doda (Demi)

KËRKESË

Shtetasi Hasan Memia, i biri i Isufit dhe i Butes, i datëlindjes 10.5.1945, lindur dhe banues në fshatin Shumicë, komuna Tropojë-Fshat, rrethi Tropojë, kërkon shpalljen të vdekur të nënës së tij, Bute Haxhi Memia.

KËRKUESI
Hasan Memia

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Zhan d'Ark", prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 258 472 (Kryeredaktori).
Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2008 është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 16.10.2008
Doli nga shtypi më 18.10.2008

Tirazhi: 3300 copë	Formati: 61x86/8

Shtypshkronja "Ilar"
Tiranë, 2008

Çmimi 56 lekë